

INTERVISTË ME XHAVIT GASHIN

Prishtinë | Data: 24 shkurt, 2021

Kohëzgjatja: 120 minuta

Të pranishëm:

- Xhavit Gashi (I intervistuari)
- Anita Susuri (Intervistuesja)
- Besarta Breznica (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë te komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Anita Susuri: Zotni Xhavit, nëse mundeni me u prezantu, me na tregu diçka për vetën? Për prejardhjen? Familjen?

Xhavit Gashi: Okej faleminderit shumë, po. Unë jom Xhavit Gashi, jam i lindur më 29 qershor 1973-tën në Studenicë. Studenica është ni fshat i vogël në komunën e Istogut. Pra, kur thom jom lindë në Studenicë është, realisht jom lindë n’shpi në Studenicë. Jom prej familjeve që s’kem pasë rastin, për shembull prindtë e mi ndoshta të trajtohen në spital apo t’i bojnë lindjet në spital, por të gjithë fëmijtë, sa jemi tetë, t’gjithë jemi lindë n’shpi në Studenicë. Pra, kam katër vllazën edhe katër motra. Prindi, baba, m’ka vdekë në vitin ‘91, ndërsa nana fatmirësisht ende jeton.

Si fëmi, fëmijërinë e kam kalu në fshatin Studenicë. Shkollën fillore e kom përfundu në, shkollën fillore në Vrellë që është diku dy kilometra larg fshatit. Normalisht, si të gjithë fëmijtë e asaj kohe [kemi shku] në këmbë. E kushtet në të cilat jam rritë, më afër varfnisë. Normalisht, familje e madhe edhe për faktin se si shumë familje kosovare kanë qenë pjesë e lëvizjeve apo iniciativave tjera, përpjekjeve për arritjen e lirisë, pavarësisë apo qoftë ambicieve tjera për me pasë me jetu. Me pasë nivelin e trajtimit, atëherë në ish Jugosllavi, si t’paktën të jetojmë me dinjitet, po normalisht neve i kem pasë të cingurara shumë liritë. Nganjëherë edhe gjuhën edhe flamurin edhe edukimin.

E babai im ka qenë luftëtar në njësitë Kaçake¹ në 1945-‘46 pra kur ka qenë ma së fundi në luftë. Edhe këtë e kom marrë vesh, normalisht edhe prej babës, po edhe prej shokëve të babës tem. Para se me vdekë baba, kur kanë ardhë me vizitu edhe na kanë tregu që Nimani, që pra ishte emri i babës tem, baba im pra i ka shpëtua disa herë prej tyre. Njëri tregonte rastin e vërtetë qysh osht’ plagos ai në Novi Pazar, pra atëherë kur kanë luftu kundër njërive çetnike² atëherë, si njësi kaçake kta. Edhe do të thotë

¹ Të jashtëligjshëm, banditë, të njohur edhe në rajone të tjera të Ballkanit si *hajduk* apo *uskok*, të konsideruar nga shteti si kriminelë të thjeshtë, por shpeshherë ithtarë të një agjende politike të çlirimit kombëtar.

² Lëvizja serbe e lindur në fillim të Luftës së Dytë Botërore, nën udhëheqjen e Draža Mihailović-it. Emri i saj rrjedh nga çeta, bandat guerile anti-osmane. Kjo lëvizje adoptoi një program të Serbisë së Madhe dhe për një periudhë të kufizuar ishte një guerile anti-pushtuese, por më së shumti e angazhuar në bashkëpunim me Gjermaninë naziste, qëllimi i saj kryesor mbetet bashkimi i të gjithë serbëve. Lëvizja ishte përgjegjëse për një strategji terrori

evokojshin kujtime nga ajo kohë. Pra, ma shumë kem ditë ndoshta në vitin e fundit për pjesëmarrjen e babës n'atë luftë, sesa krejt jetës paraprake, se unë isha atëherë 16 vjeçar.

Pra, si fëmi jemi eduku me atë edukatën kombëtare, edukatën familjare me vlerat çfarë e bëjnë një person që t'jetë me dinjitet, me vlera normalisht kombëtare, po edhe me një, me vlera të njerëzisë. Edhe ndoshta ajo është ma e rëndësishmja që mu m'ka ndihmu me mujtë me shërby me nderë në krejt kto vite që kom bo tash ma shumë se 22 vite. Pra, unë jom penzionu nga puntë e shtetit vitin e kaluar. Por, për këto 22 vite gjithmonë kur në çdo moment kur kom ardhë deri te ni arritje që e kom bo për shtetin tim, kuptohet duke m'u jep mundësitë nga shteti im, suksesin gjithmonë ia kom dediku edukatës së babës tem kryesisht edhe nanës, po edukatës familjare.

Pra, aty edhe pse nuk i kishim kushtet, pra tregova, ma shumë jemi kategorizu në nivelin e familjeve të varfëra. Kjo deri në vitin 1987-'88, kur vllau ynë i madh i cili edhe ai kishte qenë pjesë e demonstratave në vitin '81 edhe pas përfundimit të shkollës turistike, Shkollës së Lartë Turistike në Pejë u leju që të punësohet vetëm për një ditë. Por pasi e kuptuan se kush ishte se ai kishte drejtuar demonstratat në Istog atëherë, atëherë demonstratat për republikë, pra u largua nga puna në vitin '81. Vetëm pas një dite punë. Atëherë, domosdo që u detyru që të lëshojë Kosovën edhe ni, gjaja e vetme që kishim ndoshta si pasuri ishte ni lopë edhe u detyrum ta shesim edhe atë që ai t'i siguroj mjetet për me dalë jashtë vendit për një të ardhme ma t'mirë për veti dhe për familje.

Anita Susuri: Zotëri Xhavit...

Xhavit Gashi: Po.

Anita Susuri: Para se me vazhdu te kjo pjesa patëm me u ndalë pak te baba juj...

Xhavit Gashi: Po.

Anita Susuri: Ju thatë që ka qenë pjesë e lëvizjeve...

Xhavit Gashi: Kaçake, po.

Anita Susuri: A ka qenë ai i përndjekur pastaj gjatë komunizmit? Sepse e di që i kanë përndjekë.

Xhavit Gashi: Po, po. Ka qenë... përndjekjet kanë qenë në forma të ndryshme. Normalisht, ma herët se unë nuk i... unë ndoshta është keq që nuk kom huluntu, po në periudha t'caktume ka qenë edhe i burgosun. Jo shumë, po ka majtë edhe burg. Mirëpo, persekutimi apo përndjekja ka qenë edhe moslejimi, për shembull kërkush nga familja jonë s'ka mujtë të punësohet dikon, për shembull... ose

kundër joserbëve gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe u ndalua pas vitit 1945. Mihailović u kap, u gjykua dhe u ekzekutua në vitin 1946.

forma tjetër, për shembull unë niherë e kom pasë ni interesim që kur ishim ne n'shollën fillore n'klasë të tetë m'duket, po e përmendi vetëm ni shembull, ka qenë ni kampanjë e rekrutimit që rekreutojshin fëmijtë në klasa, në klasën e fundit të shkollës fillore ata që kishin interesim për shërbim ushtarak atëherë.

Po flas, ai ka mund të jetë viti ndoshta '80 ashtu përfarësisht mos të gaboj me vit. Mirëpo, unë i plotësoja të gjitha kriteret. E kisha vetëm ni katër në kimi edhe atë bëra përpjekje e përmirësova. Por, në fund nuk u pranova sepse isha djali i Nimanit edhe nuk kisha mundësi. Mirëpo, kanë qenë, domethonë, ka qenë halë në sy. Ka pasë edhe tjera orvatje, për shembull nga Partia Komuniste atëherë. Ka qenë e shtrime nëpër fshatra që prindi im dhe familja ime t'jenë përjashtuara. Atëherë nëpër katune i kanë qujtur si të leqitura apo të përjashtuara. Ka pasur edhe aso iniciativa.

Unë fatmirësisht kam qenë nga një fshat, pra kemi jetu në një fshat ku komuniteti apo fshatarët edhe pse ka pasë disa komunistë edhe nga fshati jonë, domethonë ne jo vetëm që nuk jemi përjashtuar nga fshati po ne kemi pasur mbështetje shumë t'madhe. Edhe prindi im, Nimani, ka qenë i njohur si një lider. Virtytet që e kanë bo ata me i rujtë ato vlera, unë besoj që kanë pasë t'bajnë, përpos vullnetit e përkushtimit të tij që t'i ruj ato vlera patriotike edhe nga të lexumit e shumtë që ai e ka ba gjatë jets t'vet.

Për shembull, ai ka pasë vetëm katër vite shkollë po vazhdimisht ka lexu shumë. Jo vetëm vepra romane, po ka lexu, për shembull të gjitha revistat që kanë qenë në ish Jugosllavi. I ka porositë, i ka pagu edhe i kanë ardhë në Bashkësi Lokale, për shembull, në Vrellë edhe na si fëmi jem shku i kem marrë ose ai vet. Do të thotë, ka vazhdu që të lexojë edhe të informohet me ngjarjet jo vetëm në ish Jugosllavi, po çka ndodhë edhe në botë. Pra, gjithmonë ka qenë i interesuar që t'dijë ma shumë të lexojë ma shumë. Po kur shkojmë te leximi, për shembull atë shprehinë e leximit ka dashtë m'u kanë i sigurtë që e pason edhe te ne.

Për shembull, ne s'kemi pasë qoftë kur jom kanë duke u kujdesë për bagëtinë apo mos t'flasim për detyrat e shtëpisë që gjithmonë u kujdesë që ne t'jemi të rregullt me detyra të shtëpisë. Por, plus asaj përveç romanëve që i kishim si detyrë nga shkolla që t'lexojmë, ai kishte listën e romaneve, veprave që donte të sigurohej që ne i lexonim. Për shembull, veprat e Rilindasve ne gati t'gjitha i kishim si kusht nga prindi që t'i lexojmë, por jo vetëm t'i lexojmë por edhe t'i diskutojmë me të. Të tregojmë se çka kemi kuptu, si për jetën, për vlerat kombëtare e kështu me radhë.

Pastaj, ni element tjetër i tij ishte edhe pastërtia, pedanteria. Për shembull, në ato kushte të vështira, ai gjithmonë vishej pastërt, bukur, edhe ushqimi ka qenë, ushqimi... i ka kushtu rëndësi shumë ushqimit, që ne t'ushqehemi mjaftueshëm në ato mundësitë që i kishim. Por me ushqim, për shembull ka ndodhë na ka rreshtu para se të shkojmë n'shollë, sepse ne ishim tetë fëmi shumica ishim në kohën e njejtë që shkonim n'shollë edhe na ka rreshtu edhe na ka inspektu. Për shembull, ka thanë, "Nal të kqyri". Na ka kqyrë jakat {shpjegon me duar} na ka bo m'i dathë, s'kem pasë këpuca po opinga atëherë.

Do të thotë, m'i dathë opingat, çoraptë me kqyrë mes gishtave a janë t'pastërt. Domethonë, na ka... u dashtë, u kujdes për këto.

Pastaj, mikëpritja ka qenë ni vlerë tjetër që për shembull, në familje edhe pse ne me siguri keni dëgju që përpara kanë jetu familjet në bashkësi të mdhaja familjare deri 50-60 anëtarë. Prindi im ka qenë iniciator që ai t'ndahet ma herët prej familjes. Mirëpo, edhe pse ka qenë i ndarë prej vllaznive të vet, gjithmonë mesat, vajzat e axhës apo hallat, kushdo që ka ardhë s'ka... pa marrë parasysh për kë e kanë dediku atë vizitë, s'pari kanë ardhë te ne, sepse ai gjithmonë i ka pritë mirë, u kujdes për atë.

Por, me temën që, m'fal që ndoshta u zgjerova pas temës konkrete që m'u drejtuat. Do të thotë, përndjekja nga regjimi për shkak të veprimt të tij në lëvizjen kaçake kanë vazhdu. Vetëm mendoj nëse mund t'qij janë dalë apo, ose ndoshta kisha mujtë ma mirë me qujtë ka qenë ky aspekti tjetër i gjindshmërisë tina si një person me vlere edhe komunikues, të cilat besoj i kom trashëgu prej tij. Ka qenë një komunikues shumë i mirë. Për shembull, ka pasë njerëz siç e përmenda rastin në fshat edhe pse ata kanë qenë të detyruar në një formë t'i zbatojnë vendimet e Partisë. Për shembull, nëse ata kanë thanë duhet t'përrjashtohet kjo familje, është dashtë t'përrjashtohet. Ata edhe megjithatë në fakt neve nuk na kanë përrjashtu, a po kupton, nga fshati.

Ashtu ka ndodhë po m'duket edhe me rastin kur unë isha 16 vjeçar në shkollë edhe pse kompania ishte shtetërore atëherë, neve na u mundësu për herë t'parë ni element që ne të... edhe pse s'ishte drejtpërdrejt i lidhur si instrument shtetëror, prapë kompania ishte shtetërore, e qujtur "Korenik" edhe hera e parë që neve na u mundësu ta hapim ni shitore në fshat. Pra, me mjetet që vllau dërgonte nga Zvicrra, na patëm mundësi, e ndërtum ni objekt të vogël edhe e hapëm ni shitore.

Edhe unë isha në moshën 16 vjeçare, isha në vitin e tretë të shkollës të mesme edhe pata mundësinë t'jem edhe nxënës edhe isha udhëheqës i shitorës apo atëherë si shitës kryesor. Nga ai moment ne edhe filluam të rimëkëmbëm si familje. Pra, edhe t'hyrat nga shitorja edhe vllau i madh ishte në Zvicërr. Ndërkohë patën mundësinë të punësohen edhe dy motra në një fabrikë lokale që ishte e tekstilit për përpunimin e tepijave dhe mbulojave që ishte në Vrellë, pra afër shtëpisë tonë, dhe ne filluam të rimëkëmbemi si familje.

Pastaj, si qëllim kryesor i prindit tim ishte që të shkollohemi të gjithë. Ai u kujdes që ne të jemi në vijën e orientuar të edukimit. Fillimisht dy fëmijtë e mdhej, për shembull motra e parë ishte e martuar herët edhe ajo nuk pat' mundësi të shkollohet. Ndërsa për rastin e vllaut të parë, ai shkoi në Zvicërr për të punu, për të mbijetu. Ndërsa vllau i dytë që ishte, ai i filloi studimet në arkitekturë. Tani është arkitekt, normalisht ka diplomu shumë ma herët. Pastaj ni motër tjetër nuk e deshti shkollën, sepse babi, babai ishte shumë i fokusuar i orientuar edhe vajzat të shkollohet.

Nji element tjetër ishte, në ato kushte të vështira, na u mirrshim kapak me bujqësi me pemë, perime e fruta të ndryshëm edhe i shitshim. Për shembull, kishim disa trupa me qershi dikun... ishim t'vetmit

që kishim ni farmë t'vogël. Pastaj i shfrytëzonim 50-60 ari tokë tri-katër herë në vit me rendimente t'ndryshme. E punonim me libra të agronomisë, sepse ai kujdesej që ne t'jemi të sigurtë që rendimentet t'jenë të suksesshme n'punën që bënim atëherë.

Edhe m'kujtohet ni rast, për shembull, ishte një, një prej vajzave të fshatit që ishte në studime dhe familja nuk ishin mirë me mjete edhe atëherë pra edhe pse ne e kishim burim për mbijetesë vet ato t'hyra që na vinin nga shitja e atyne frutave ose pemve, edhe tha, "Okej, ni sasi du me ia çu", për shembull, filan familjes "sepse osht' ajo n'shköllë edhe nuk po mujnë me përballu". Pra ishte i kujdesshëm që edhe thonte gjithmonë, "Pa shkollimin e femrave veni jonë nuk do të zhvillohej". Pra, ai mentalitet n'atë kohë ishte jo i zakonshëm, për shembull nga axhallarët apo njerëzit e tjerë në komunitet.

Anita Susuri: Zotëri Xhavit, dashta me ju pyetë pak edhe për vendin ku jeni rritë si fëmi, a ka qenë ma shumë vend ku njerëzit janë marrë me bujqësi? Çfarë vendi ka qenë? Si e kujtoni ju?

Xhavit Gashi: Po, është vend si shumica e fshatrave në Kosovë, kryesisht njerëzit kanë jetu me bujqësi. Edhe unë e përmenda një herë, për shembull, herë pas here edhe unë kam pasë një lopë disa dele ose, për shembull, osht' dashtë edhe të prejme dru për dimër, vet i kemi siguru. Kem pasë ni gomar, ai ka qenë mjeti ma i sofistikuar që kem pasë (qeshë) për transport edhe për, për shembull, çfarëdo që kem pasë për me bajtë nga ara, nga fusha por edhe për dru atë e kemi pasë. Po, fshati kryesisht kanë jetu prej fushës, prej punës me bujqësi, blegtori, bujqësi. Edhe normalisht ka pasë ni numër të madh të djemve të cilët kanë jetu jashtë vendit, në gurbet, të cilët kanë shku, jo vetëm për veti për ni jetë ma t'mirë, po si në përgjithësi në Kosovë që i kanë ndihmu familjes.

Anita Susuri: Çfarë fëmijërie keni pasë ju? A jeni angazhu ma shumë rreth punës apo si e keni kalu? Çfarë kujtime keni?

Xhavit Gashi: Në fëmijëri, në fëmijëri të hershme normalisht përpos shkollës kemi punu pra, kemi punu edhe puntë e fushës. Ni moshë ma t're jemi angazhu t'gjithë bashkë, për shembull kur ka qenë koha e të korrave, për shembull misër kemi pasë apo fasule kur kemi mbjellë apo kopshte. Ju tregova, na jemi marrë pak me sera, me fruta t'vogël, me pemë, me perime. Gjithmonë jemi angazhu gjithë familja, kemi punu. Fëmijëria ime s'ka qenë ndryshe prej fëmijërive të fshatit, në përgjithësi ashtu kemi punu.

Por duke u rritë, po mendoj, diku interesimi për aktrim më ka lindë ka vitet e fundit të shkollës fillore. Unë kom pasë ni prirje, si ta them, për humor edhe këtë mund t'them e kom trashëgu prej njërit prej axhëve t'mi. Ai ka pasë shumë bagëti, ka pasë shumë krerë lopë, dele, gomarë, maca ka pasë shumë. Por fëmi s'kanë pasë, domethonë, me grunë e vet ata janë kujdesë. Kanë pasë gjithçka për ta. Kanë qenë kto bagëtia, loptë, delet.

Mirëpo, ne edhe pse ishim t'ndarë siç shpjegova më herët e kemi pasë obligim që gjatë verës të kujdesem, t'ju ndihmojmë atyre se s'kanë fëmi. Edhe ditëve të tjera, por zakonisht gjatë pushimit veror. Nuk ka qenë çështja a kem dëshirë ne a jo, por jemi detyru që të shkojmë t'ju ndihmojmë atyre në bjeshkë. Edhe pse nuk kishim ne vet për çka t'dalim në bjeshkë. Po mendoj, për çka po, për m'i shiju bukuritë. Por, atëherë nuk ishte i shprehur sikur sot që është elementi për si atraksion, bjeshka si atraksion. Po ishte ma shumë si nevojë për me shfrytëzu gjatë kohës t'verës për blegtori, për bujqësi.

Anita Susuri: A keni qëndru në ato stanet apo ku keni qëndru?

Xhavit Gashi: Po, po, kem qëndru edhe fatkeqësi është pjesa ku kanë dalë baritë në bjeshkë atje që quhen, janë bjeshktë të thata atje në Korenik, Paja. Ato janë bjeshkë pa ujë edhe gjatë kohës, për shembull, tani është koha në shkurt, në mars që duhet t'dalin baritë edhe të mbulojnë borën. Janë qujtë ato si rezervaret e borës, atëherë i kanë qujtë smet, smetje. Është dashtë t'mbulohen me gjethe edhe me plastikë, me mbulojë plastike që të rezervohet bora që kur t'shkojnë me bagëti ta shfrytëzojnë atë edhe për bagëti, por edhe për pije. Domethënë, kanë shfrytëzu ujë nga bora sepse s'kem pasë mundësi që ta bartim ujin prej fshatit, po e kem shfrytëzu gjithmonë. Kem pi ujë tërë verën edhe ne, por edhe bagëtia ose çdo gja që kem pasë me veti e kem përdorë nga bora.

Nuk ka qenë e lehtë sepse nganjëherë ato rezervaret nuk kanë qenë shumë afër stanit, që i kem qujtë stane apo dikush bana, ato që i kem përdorë për jetesë. Kanë qenë ashtu në formë {shpjegon me duar} konike, noshta i keni pa diku. Ka pasë edhe forma tjera, por zakonisht n'ato që kanë jetu kur i kem ndihmu axhës kanë qenë ashtu. Shumë klasike, jetë interesante, jo e lehtë, e vështirë. Nuk ka qenë, mund t'them, nuk ka qenë shumë e pëlqyshme prej neve, por e kem marrë si obligim që duhet t'ndihmojmë. Po kur e përmenda në të gjitha këto sfida e vështirësi nuk ka mungu, për shembull, sensi i humorit të axhës.

Kanë kalu shumë ni jetë të vështirë, po janë dashtë shumë mes vete me grunë e axhës, me Zizë, hallën Zizë, tash të ndjerë dytë. Po ata kanë kalu shumë mirë. Por, edhe mixha Lul që e kanë njoftë në atë regjion, të gjithë njerëzit ka pasë edhe sens të humorit. Edhe unë duket e kom trashëgu nga ai. Edhe unë kom fillu, për shembull në ndejat që kemi pasë atëherë në familje apo në rrethin e gjerë aty n'fshat ku jemi kanë të ftum në ni djalë po vajzë pjesë e ceremonisë, nganjëherë një, dy, tri ditore dasmat apo çfarëdo ceremonie që kem pasë. Unë edhe nuk kom hezitu me bo ndonjë shfaqje, jo teatrale, po në formë humori apo skeqi me dikë. E kom pasë ni prirje.

Masandej, kur po ashtu nga klasa tetë kom fillu m'u marrë edhe me disa shkrime, disa poezi. Si nuanës atëhere në shkollë të mesme kemi pasë edhe disa leksikone me kujtime edhe aty kisha qef t'kontriboj ndonjë vjerrshë, ndonjë shënim kështu interesant. Por, pas përfundimit të shkollës të mesme atëherë, tani është i ndjerë Nazmi Muslijaj, ishte, u kujdesë që t'shërbej si koordinator i rinisë në disa fshatrat, të na organozojë edhe t'i bojmë disa shfaqje. Të na pregatisë si aktorë amator edhe na bajmë disa shfaqje nëpër fshatra.

Edhe ishte shumë interesante edhe për të kriju na aftësi t’reja m’i shpreh ato aftësitë tona që kish shumë t’ri që kishin dëshirë t’bohen aktorë po edhe t’njejtën kohë argëtonim njerëzit nëpër fshatra të cilët s’kishin tjetër formë të argëtimit. Pra, bonim shfaqje. Më kujtohet kemi ba në fshatin tonë Studenicë, në Vrellë, në disa fshatra të tjerë, Jubllanicë e Madhe, dhe siç ju thashë, kryesisht nëpër disa shtëpia që janë përdorë për shërbimet e Bashkësisë Lokale apo në pamundësi të shfrytëzimit të tyre në ndonjë xhami apo ndonjë odë e dikujt që ishte ma e madhe edhe e përshtatshme për këtë qëllim.

Anita Susuri: Zotëri Xhavit, ky fshati a ka qenë fshat i përzier apo me etni shqiptare?

Xhavit Gashi: Vetëm shqiptare. Në të vërtetë kemi pasë nja dy-tri familje romë kanë qenë, po vetëm shqiptare. Ato familje kanë qenë mes fshatit Vrellë dhe Studenicë, po edhe ato kanë qenë mirë të integrum, të respektum, qashtu.

Anita Susuri: Ju deri n’klasën e tetë keni qëndru n’fshat apo keni vazhdu...

Xhavit Gashi: Jo, une kom vazhdu deri në momentin kur jom regjistru në Fakultetin e Gjuhës Angleze, në vitin ‘91. Pra, kom jetu në fshat. Edhe mas asaj kohe unë kom jetu me qira në Prishtinë, mirëpo gjithmonë çdo vikend apo pushimeve kom jetu në fshat, në Studenicë.

Anita Susuri: Ju shkollën e mesme e keni fillu n’vitin sa po i bjen...

Xhavit Gashi: ‘86-‘87, qashtu m’duket.

Anita Susuri: Domethonë prej vitit ‘81 osht’ ni rrymë ndryshe politike që ka fillu në Kosovë për shkak acarimit, gjendjes prej demonstratave ‘81 edhe vitet ‘86 kanë qenë pak ma t’vështira. Si kanë qenë për juve? Ju për shkollën e mesme keni vazhdu në Prishtinë apo?

Xhavit Gashi: Jo, shkollën e mesme unë kom vazhdu në Istog. Pra, në Istog deri në ‘90. Pra, ‘90-‘91 ka qenë viti kur jom diplomu dhe ai ka qenë viti i fundit kur ne kemi mujtë t’jemi ende në objekte shkollore.

Anita Susuri: E tash unë e di që ni kohë pas demonstratave rinia shumë ka qenë e mbikqyrur edhe nuk është leju të rinjtë me u mbledhë. Qysh ka qenë për juve qajo? Qysh e keni përjetu qat’ kohë, shkollën e mesme?

Xhavit Gashi: Për shembull, na tash përmendëm për komunitetin apo fshatin a ka qenë i përzier apo i banum vetëm prej shqiptarëve. Fshati im ka qenë ashtu, mirëpo Istogu ka qenë si komunitet i njohur që ka pasë shumë serbë. Në shkollë ne i kem pasë klasat serbe dhe klasat shqiptare. Në shkollë e kemi

pa privilegjet që kanë pasë nxansat serbë për shembull edhe mangësitë që s'kemi mujtë m'i gzu ato privilegjet që i kanë pasë për shembull fëmijë serbë.

Anita Susuri: Çka kanë pasë, për shembull ata si privilegj?

Xhavit Gashi: Po ndoshta klasat ma t'mira, ndoshta... nuk m'kujtohet çdo gja, po normalisht kanë qenë të lirë, e kanë pasë sigurinë sepse ka qenë sistemi, [kanë qenë] pjesë e sistemit. Për shembull, ne, unë e përmenda faktin që unë kam pasë qef me u marrë me aktrim. Po dy-tri herë kom qenë, për shembull kandidat me marrë pjesë në garat krahinore atëherë të Kosovës edhe për shkak që i kam pasë dy poezitë që m'kanë pëlqy shumë atëherë kanë qenë kombëtare, atëherë nuk m'u ka leju. Vetëm nëse du me ndrru une poezinë, se nuk bon.

M'kujtohet ni profesor edhe ka qajhtë ka thanë, "Po m'vjen keq se shumë mirë p'e reciton. Edhe e di që e kishe nxanë vendin e parë, po nuk guxojmë se na del telashe edhe neve me këtë poezi". Sepse ka qenë njëra prej poezive që me siguri atyne iu kish shkakto telashe me përmend Shqipërinë apo shqiptarinë apo diçka të tillë. Ata s'kanë pasë pengesa, po mendoj për serbët. Mirëpo, na është interesant se rastet e konfliktit mes studentave shqiptarë e serbë, unë t'paktën nuk kujtoj, nuk kujtoj.

Dihet ne n'atë kohë kemi pasë ende gjuhën serbe si gjuhë që u dashtë të mësohet, njo prej gjuhëve të huja, po, ka qenë e obligume në të gjitha klasat. Mu m'duket dy orë në shkollë të mesme i kemi pasë. Unë nuk e shoh, nuk e kom pa gja negative, sepse ta jep mundësinë me mësu edhe ni gjuhë tjetër. Unë kom qenë me ni drejtim ku kom mësu edhe latinisht edhe anglisht e kem qenë drejtim i bashkëpunimit për shkenca natyrore edhe kem pasë edhe latinishte, m'kujtohet atëherë.

Mirëpo, në vitin '89 siç e dini demonstratat e protestat, ne prej Istogut, për shembull, jemi aktivizu. Në kamë shumica e klasave kanë ardhë me iu bashkangjtitë demonstratave. Siç kanë ardhë prej krejt Kosovës.

Anita Susuri: A keni shku edhe ju?

Xhavit Gashi: E tash une e kom pasë, ni profesor e kemi pasë i cili ka qenë në Kryesinë e Partisë Komuniste edhe ai na ka mbyllë neve n'klasë mos me dalë. Domethonë, klasën tonë na ka mbyllë edhe i ka pasë mundësitë sepse i ka shfrytëzu edhe autoritetet serbe lokale aty, po ka pasë të shkollës tonë që kanë shku. Domethonë, ne, nuk e di a ka pasë ndonji klasë tjetër që nuk kemi shku.

Niherë na kanë lanë, kanë thanë, "Po, po vijmë", jemi shku disa kilometra. Pastaj po nuk kemi shku krejt jemi kthy. Kanë thanë, "Po, do të shkojmë në mënyrë t'organizume". Qëllimi ka qenë vetëm t'na lokalizoj edhe t'mos na lejoj daljen. Mirëpo, kemi marrë pjesë, për shembull në nivel lokal se pastaj fillunë ato protestat edhe nëpër fshatra. Na kemi bo protesta, demonstrata nëpër fshatra, jem kanë pjesë e t'gjitha atyne aktiviteteve edhe t'organizimeve, po edhe të pjesëmarrjes. Ato e kem bo.

Pastaj në vitin '91 kur u organizun ato celulatat e para të organizimit mbrojtës, si mbrojtje territoriale, po ashtu edhe aty jom angazhu menjëherë që t'jem... atëherë u organizojshin rojet e fshatit, identifikimi i të rinjëve që mundën me kanë si potencial për shërbim në mbrojtje të popullats. Aty bashkë me disa të ri të fshatit i kemi shërbu edhe si roje ose t'paktën mbledhjen e informacionit, lëvizjen e automjeteve, policisë ose të ushtrisë serbe n'atë kohë.

Anita Susuri: E kur kanë ndodhë këto, për shembull organizimet, a kanë qenë diku msheftas me ni shpi t'hujë apo si osht' marrë vesh që po bohet ni organizim?

Xhavit Gashi: Po, pyetje e mirë. Shumë herë, për shembull, atëherë ka qenë fakt se ka qenë vetëm ni lëvizje në fillim. Ka qenë vetëm lëvizja Lidhja Demokratike e Kosovës edhe kryesisht kanë ardhë nga, çdo fshat e ka pasë kryesinë e fshatit sepse tanë vijnë nga fshati. Edhe në kryesi të fshatit, për shembull kush kanë qenë dy-tre personat ma t'besueshëm ose ma aktivë përmes tyre pastaj janë shpërnda informacione ë'qëllimeve të përbashkëta, si t'organizohemi, si t'veprojmë? Ashtu. Po ka pasë ni organizim shumë të mirë do të thotë edhe për çështje tjera, po sidomos çështje të karakterit kombëtar.

Anita Susuri: A ju kujtohet, për shembull kjo kohë, krejt këto ngjarje që kanë ndodhë, çka keni dëgju? Qysh e keni përjetu? Për shembull, baba juj m'tregutë që ka qenë pjesë, a ju ka këshillu edhe ai apo?

Xhavit Gashi: Shumë pyetje e mirë. Unë ju tregova, ai ka folë për luftë po ma shumë ka folë për të ardhmën. Ka dashtë na të drejtohem i nga e ardhmja. Mirëpo, gjithmonë ka dashtë t'jetë i sigurtë që te na vazhdojnë me kanë t'mbjelluna ndjenjat patriotike, me i dalë zot venit. Edhe tregova, shpinë e kem pasë shumë t'vogël po njana prej dhomave t'shpisë e ka pasë krejt sa njani hapësira, ballë e një shpije ka qenë flamuri kombëtar. Edhe ne si fëmi gjithmonë, për shembull kemi pytë njëherë për shqiponjën, "Bab, çka osht' kjo?" Unë edhe vllau ma i vogël që e pave ti n'fotografi [i drejtohet intervistuesës]. Na kemi qenë noshta ni vit e diçka diferencë në vjet, po na kanë thirrë si binjaktë e Nimanit apo të Ryvës, të nans e të babs. Edhe ka thanë, "Bab, me kto kthetra, kto kthetra ni ditë kanë me largu armikun prej neve edhe kanë me na ardhë neve drita, liria". Edhe do të thotë gjithmonë u kujdesë.

Pastaj, normalisht ka folë shumë për Shqipërinë, për fatkeqësi se niherë nuk kem pasë informata shumë t'sakta çfarë po ndodhë në Shqipëri. E kem pa Shqipërinë edhe lidëshipin e shqiptarëve si shpresë ndoshta për të ardhmën, se nuk e kem ditë, për shembull saktësisht se lidëshipi i shqiptarëve ka qenë diktatorial për popullin e vet. Por, na n'atë kohë nuk osht' sekret si shumica njerëzve të ciltë kanë pasë orientim kombëtar që e kanë dashtë vendin e kanë pa Shqipërinë edhe atëherë diktatorin. Po ne s'e kemi ditë që ka qenë diktator, si ndoshta n'shpresë që ka me na dalë zot ndonjë ditë. S'e kemi pa ndoshta atë që kemi pa n'televizor, ndoshta ndonjë kongres apo ndoshta ndonjë aktivitet. Kemi mendu, na ka jep shpresë që ka me u kujdesë për neve Shqipëria, a kupton. E ne nuk kemi ditë që s'ka aftësi edhe për veti ose fatkeqësisht që e ka shtypë ose ka qenë diktator edhe ndaj popullit t'vet.

Por, te këshilla për luftën osht' interesante se po m'duket ka qenë diku katër ose pesë muj para vdekjes kur ka bisedu baba me mu edhe me vllaun tjetër ma t'vogël. Por, ka qenë edhe vllau i cili edhe pse s'ka qenë n'luftë ka qenë edhe arkitekt e ka bisedu edhe me to edhe ka thanë, "M'duket..." se u pa se dhuna e represioni nisen m'u shtu. Tha, "Djemtë e mi, po du me bisedu diçka me juve". Tha, "Une", tha, "jom smutë", se ka qenë smutë prej kancerit edhe e ka ditë prej çka është smutë, në mushkri. "Po duket", tha, "që nuk do të ketë zgjidhje tjetër përpos t'ia kthejmë pushkën armikut". Bash kështu edhe ai përmendi pak rastet e eksperiencës të tij, për shembull në Novi Pazar atje ku ka luftu vet.

E n'atë kohë ka qenë e vështirë. Tregonte qysh kanë mbrojtë shqiptartë edhe boshnjaktë, do t'thotë kta si forca që kanë qenë kaçake do t'thotë ka luftu kundër regjimit, po i kanë mbrojtë civiltë. I kanë mbrojtë pjesëtarë, gra, fëmi, pleq që kanë qenë shqiptarë e boshnjakë. Po thojke, "Ka pasë raste që kem mbrojtë edhe civilë serbë", edhe tregojke që tash a po vjen kjo kohë që ka me ka me pasë, po doket që duhet me pasë nevojë me ia kthy pushkën armikut, "Atëherë", thojke, "ju duhet me ditë ma s'pari me matë vetën që, a doni ju se kërkush s'munet me ju shti me zor me me i dalë zot vendit". Normal, që këshilla e tij gjithmonë ka qenë që na t'i dalim zot vendit. Mirëpo, thojke, "Ma s'pari duhet me matë vetën, a don, a s'don? Nëse don, atëherë", thojke, "duhet me kanë t'kujdesshëm që me ba luftën e pastër". Thojke, "Nëse e bon luftën e pastër gjithmonë keni me qenë fitimtar. Mundeni me u vonu, po do të fitoni".

Edhe tjetrin aspekt ishte që thojke, "Hajt t'mendojmë me çka bohet lufta", pytja jonë ishte armtë ku janë, kishim pak armë. Kishim dikun... edhe ai deri n'atë moment s'na ka tregu që kishte diku ndonjë revole me dalë me ble ni armë tjetër, po mungonin armtë. "Po, armtë", tha, "mos i keni problem se armtë lufta i bjen. Kur ndodhin lufrat vijnë armtë, ajo nuk osht' problem. Po normalisht nuk mundemi me pasë armë si paltë tjera, po armtë vijnë". Po tjetra këshillë e tij ishte që duhet t'dijmë, "Nëse luftoni, nëse boni luftë t'paqtë duhet të dini se prapë në Kosovë do t'jenë serbtë, do t'jetojnë serbët edhe duhet të jetoni prapë bashkë me ta". Thojke, "Ose hajt qe s'po metkan serbë në Kosovë", thojke, "duhet me ditë se Serbia osht' kojshi, fqinje. Duhet me bo tregti, duhet me bo biznes, duhet me zhvillu vendin. Gjitha kto", thojke, "ndihmojnë me ditë në kohën kur nëse ti bon luftë t'pastërt atëherë mundësitë e bashkëpunimit mas luftës janë ma t'mira nëse ki ksi kondita".

Që ishte interesant prej ni njeriu fshatar që kish vetëm katër vjet shkollë, po që kish lexu shumë. Kjo m'ka ndihmu edhe mu n'jetë, për shembull me shërbimin tem n'luftë edhe vllaut tem ma t'vogël. Po edhe pastaj me kanë ma i hapun rreth koncepteve pas luftës, çka tash? Ka qenë interesant. Edhe tjetra është, për shembull e ka parapa n'bazë të eksperiencës t'vet te luftërat, krizat bijnë edhe fenomene tjera negative n'shoqëri. Cilat janë ato? Plaçkitjet, hajnitë. Edhe thojke, "Duhet me pasë kujdes se mundeni me u mashtru, mundeni mos me pasë kurgjo kur t'kryhet lufta".

Se n'kohën kur patëm bisedu na me babën patëm arritë me e ndërto një... t'u punu gradualisht motrat, vllaznitë t'gjithë bashkë e kem pasë ni shpi. Ndoshta ka qenë një ndër katër-pesë ma t'mirat në fshat.

Ni shpi t'madhe tri katëshe, dikun fotografitë, në fotografi ke mujtë diçka me pa, t'i tregoj fotografitë e tjera [i drejtohet intervistuesës]. Edhe, për shembull une isha menjëherë n'atë kohë do t'thotë ni vit, dy, menjëherë kishim veturë që shkoj t'u ndrru statusi i, prej një familje të varfër gradualisht t'u punu djemtë, vajzat të gjithë bashkë t'u ndërto.

Edhe thojke, “Kështu qysh janë ndërto me nderë, me nderë”, thojke, “kështu i gëzoni! Ndërsa nëse vareni, për shembull, që u shkatërru çdo gja edhe ju”, thojke, “merrni diçka t'u mendu që e rregulloni statusin e juj”, thojke, “mashtroheni se edhe ni gjilpërë”, thojke, “nëse s'e keni fitu me ndjersë, ajo s'osht' e juja. Edhe ajo”, thojke, “ju shkakton telashe n'arritje t'matutjetshme, sepse gjithmonë”, thojke, “orientoheni nga ajo me marrë diçka që s'e keni fitu, e jo me kqyrë me kriju diçka t're”.

Pra, edhe ai ish ni element shumë i rëndësishëm edhe elementi kur që e ka përmend vetëm gjilpanën, se normalisht kur shkatërrohesh krejt edhe mundësitë pastaj pas luftës për me qenë ma lehtë i thyeshëm për shkak t'nevojave t'mdha janë ekstreme, janë shumë t'mdhaja. Po mu m'duket se edhe ajo edukata e prindit na ka ndihmu që të ruhem, të kujdesemi. Se ma mirë ndoshta do t'jetë ose siç ishte gati ni vit me jetu gati si pa streh në kushte shumë t'kqija pas luftës, por mos me përzi nderin e kontributin me gjana që nuk t'shërbejnë gati n'jetë.

Anita Susuri: Deshta me t'pytë edhe pak diçka para se me vazhdu për vitet e '90-ta, për periudhën e shkollës t'mesme. Domethonë, ju n'atë periudhë jeni shkollu, jeni marrë me aktivitete kulturore edhe keni marrë pjesë nëpër organizime t'ndryshme. M'tregutë që vëllau juj ka organizu demonstrata...

Xhavit Gashi: '81-tën po, një ndër organizatorët.

Anita Susuri: A ka pasë edhe tjetër aktivitet për shembull, qysh ka qenë jeta juj si i ri apo ka qenë e preokupime me punë n'atë kohë?

Xhavit Gashi: Jo, kem qenë, për shembull, tregova, bujqësia, puntë kanë qenë të gjitha po edhe sporti. Sporti, për shembull, nuk osht' bo nëpër fusha, nëpër salla. Përpos sportit në shkollë, ne kemi bo sport nëpër fshatra, nëpër livadhe, nëpër ara, nëpër oborre në kushte jo t'mira. S'ke... për shembull, tregova deri n'klasën e tetë kur ose n'vitin e parë ndoshta të dytë kur kom fillu me punu ma shumë. Për shembull, t'mbathurat sportive kanë qenë lluks, nuk kem pasë. Por, jemi marrë.

Unë kom deshtë boksen edhe atëherë klub s'kem pasë edhe jem mundu t'imponohem të improvizoj disa kushte, për shembull thasë me zallë ose diçka ndonji pemë në oborr edhe t'ushtrij pak kështu. Ndërsa për futboll kërkush s'ka pasë qef me m'pasë kundërshtar, sepse kom qenë ni mbrojtës si shtyllë statike, jo lojtar. S'kom qenë, nuk kom qenë ndonjë sportist i... e kem pasë lojra tjera, për shembull lojra tjera që janë përdorë n'regjione t'ndryshme.

Te na, për shembull, kanë qenë lojërat e fëmijërisë kjo msheftas që luhet nga gjithkush. Atëherë ke pasë ku m'u mshef ma shumë si n'oborr, si n'arë kështu. Kile, ngile, siç quhen dikush varet n'zona t'ndryshme. Pastaj, na i kemi pasë do lojëra tjera klut edhe klinci i kem qujtë, një me dy shkopinjë një me e gjatë, një ma e vogël. Kush e gjunë ma larg me matë pastaj me metra kush e gjunë. Një tjetër lojë n'fshat që ka pasë shumë shkëmbinjë ose e kem qujtë rrasa, për shembull, me i hudhë kush mundet me goditë targetin ato tri, katër, pesë gurë që i kemi qitë si cak për me i goditë si shënjestër. Ka pasë lojëra t'ndryshme, pra ka pasë edhe aktivitete sportive.

Por, këtu me përmend, për shembull, prindi ynë për shkak t'disciplinës që ka pasë gjithmonë u kujdesë që aktivitetet tona sportive t'vazhdojnë, por të mos shkojmë diku ku ai nuk mundet me na pa. Edhe, për shembull, të mos e humbim kohën e leximit edhe detyrave që kem n'shpi. Gjysë ore, 40 minuta edhe ne kur e kemi dëgju fishkëllimen është dashtë t'kthehemi se është [koha për të] ardhë n'shpi.

Pjesa e Dytë

Anita Susuri: E ju n'viti 91 keni ardhë në Prishtinë?

Xhavit Gashi: Po, po.

Anita Susuri: Si ka ndodhë krejt kjo?

Xhavit Gashi: Po une fillimisht, do t'thotë mrena atij vitit kanë qenë disa ngjarje interesante. Na n'viti '90-të... në t'vërtetë unë n'viti '90-të kom qenë i ftum për shkak t'moshës për në qendrën e rekrutimit në Nish. Sepse ishte hala gjenerata kur dilnin në gjeneratën time t'gjithë shkonin e shërbenin në shërbim ushtarak. Fatkeqësisht, keni dëgju për kthimin e dhjetra djemve të ri në arkivole n'atë kohë. Edhe mu m'erdh ftesa. Për rekrutim kemi shku t'gjithë gjenerata. Rekrutimi ka qenë dy-tri ditë. Ata, ka qenë ma shumë analizë, vlerësim, çfarë kapacitete ushtarake munësh me rekrutu, pastaj për me shku n'shërbim.

Dhe mu atëherë aty m'u ka caktu, atëherë quhej gjinia çfarë shërbimi. Unë jom caktu që t'shërbej në njësitë, atëherë serbisht PVO³ kanë qenë njësitë kundër ajrore. Edhe jemi kthy. Pas disa mujve na ka ardhë ftesa për shërbim. Pra ishte viti '91. Atëherë ne kemi pasë, qysh me thanë, ka qenë vendim kolektiv i të gjithë Kosovës, po edhe udhëzim nga ato udhëzimet e mahershme që i përmenda si LDK që ne të mos shkojmë. Djemtë e Kosovës të mos shkojnë nëpër shërbime, se atëherë vetëm filloi lufta

³Protivvazduhoplovna odbrana - Mbrojtja kundërajrore, është një degë e manovrueshme e Forcave të Armatosura të Serbisë, e destinuar për kontrollin dhe mbrojtjen e sovranitetit të hapësirës ajrore, parandalimin e agresionit, mbrojtjen kundërajrore të territorit, objekteve të rëndësishme, qendrave dhe forcave administrative dhe industriale.

në Slloveni, tashi në Kroaci po m'duket. Edhe ne vendosëm që t'ikim nga shtëpitë, mos t'i përgjigjemi ftesës.

Ka pasë ni numër shumë t'vogël të djemve që janë përgjigjë. Zakonisht ka ndodhë ata që s'i kanë pasë familjet mirë t'informume ose nuk di çfarë arsye tjera ose dikush ka besu që nuk i vrasin ose, varet nga bindjet e njerëzve. Nuk i fajësoj. Mirëpo, unë kom qenë me shumicën, sepse nuk kemi shku. Fillimisht, për shembull, disa javë jemi largu nga shtëpia sepse u frikonim që do t'vinë forcat me na marrë me zor nëpër shtëpi. Disa javë m'duket kem qëndru diku n'bjeshkë. Pastaj kom qëndru ma shumë se tre-katër muj në Nabergjan ni fshat te dajtë e mi ku atje ka pasë mundësi ma t'lehta të ikjes nëse vijnë policia. Por, asnjëherë nuk jemi kanë që t'flejmë si duhet, dikush ka dashtë, osht' dashtë gjithmonë që t'kujdeset natën mos po vjen ndonjë automjet i policisë ose diçka n'kërkim. Mirëpo, derisa është deklarë që ma nuk do t'i kërkojnë për shërbim të obligueshëm kosovartë, shqiptartë kosovarë, atëherë ne jemi dalë. Mirëpo, është shumë interesant n'atë kohë kur unë kom nejtë ilegalisht për mos me shku në shërbim ushtarak. E pat' edhe nga disa foto që unë kom pasë floktë e gjata, stilin tjetër. Së pari, iniciativa e parë për m'i rritë floktë ka qenë momenti kur unë jom kërkë... pos pak kështu fillova në shkollë t'mesme me nifarë stili, por nuk e kom pasë idenë që do t'i kem aq t'gjata.

E për m'i rritë pak ma t'gjata, momenti kur ni vlla, ai vllau madh që ishte pastaj edhe kujdestari jonë, kujdesej për krejt familjen u interesu me gjetë diku ni pasaportë nga një mik i tij dhe i joni. Pasaportë e personit që unë, ish menu që unë ta marrë atë pasaportë e me atë pasaportë t'iku. Sepse unë s'kisha pasaportë. Ku t'shkoj? Në Zvicërr te vllau apo diku tjetër. Edhe ndërkohë unë nuk kisha vullnet, nuk kom pasë dëshirë kurrë me dalë jashtë Kosovës. Po dy iniciatore apo qysh me thanë, palë vendimarrëse pse unë nuk kom dalë jashtë n'atë kohë ka qenë edhe nana jem edhe tezza. Ato dyja e kanë ditë këtë përpjekje që unë tashti me iniciativën e vllaut edhe pak t'u u mundu me bo ni zgjidhje edhe mundem me dalë jashtë. Dyjat m'u kanë lutë n'atë kohë që, "T'lutem djali jonë mos del se krejt t'ritë na ikën".

Ishte e vërtetë se ishte ni fluks i madh i t'rive edhe unë vendosa mos me dalë edhe pse e kisha atë pasaportë. E personi në atë pasaportë i kishte floktë kaçurrela pak ma t'gjata edhe menojke që une ndoshta me shfrytëzu atë pasaportë, pa ndrru fotografi as kurgja edhe me shku me pasaportë t'tina. Atëherë fillova m'i rritë floktë e gjata, mirëpo shkun t'u m'pëlqy. Edhe me orientimin tim që doja aktor, shkonin mirë. Muzikë, muzikën e kom dashtë gjithmonë. Prapë valltar amator. Kom vallëzu nëpër dasma apo evente apo kështu për evente. Nganjëherë gjithë natën ndoshta edhe vet n'shpi kom vallëzu. Nana osht' ardhë dy-tri herë me kontrollu, "Shko flej more se u bo vonë", po kështu.

Edhe pastaj në '91-tën, me iniciativën e vllaut që është arkitekt, unë e kisha, do të thotë qëllimi im primar para iniciativës të tij ishte që t'regjistrohem në aktrim. Pra, këtë doja të bëja. Atëherë ishte gjenerata që u pranunë, nëse s'gaboj vetëm dy studentë kosovarë. Ishte po m'duket Blerim Gjoci edhe Lirak Çelaj në atë kohë nëse s'gaboj kanë qenë. Edhe shkolla për aktrim ishte e udhëhequn nga Enver Petrovci, Faruk Begolli e kështu. Kisha interesim, por vllau mandej tha, "Xhavit, derisa t'forcohet

shkolla sepse vetëm me këto dy kuadrat s'besoj që do t'jetë ndonjë Akademi e Artit prestigjioze apo kështu". Tha, "Atëherë, të kisha rekomandu masi ki edhe prirje, flet kapak anglisht edhe ki qef letërsi, regjistro gjuhën angleze" Edhe m'pëlqej ideja, e regjistrova.

Edhe vitin e parë kom ardhë, për shembull leternjoftimin tem osht' dashtë me majtë të fshehun, ndërsa për me udhëtu e kom ni leternjoftim të cilin osht' falsifiku. Ka qenë emri, mbiemri normalisht, të dhanat e ni personi tjetër që kurrë nuk e kom njoftë, po e ka gjetë ni kusheri në stacion të autobusave në Pejë. E fotografitë atëherë nuk kanë qenë dixhitale të kapura. Fotografinë e kemi ndrru edhe e kemi qitë fotografinë time të dhanat kanë qenë t'nji njerit që ka qenë i lindur '65-tën nga Zajmova e Klinës, do t'thotë shumë ma i vjetër se unë. Edhe ashtu kam udhëtu. Pra, përsonit t'cilit ia kishim gjetë atë leternjoftim, pa e ditë kush osht' ai person.

Ai fatmirësisht nuk ka dalë që ka ndonjë të kalume as kriminale... po edhe pse nuk është për fatmirësi. Por, fatmirësisht kohën kur kom shfrytëzu letërnjoftimin e tij nuk ka qenë i përndjekur politikisht apo vepër patriotike ose diçka. Sepse unë kom pasë, kom rastisë kur na kanë nalë policia edhe unë jom identifikimi me atë letërnjoftim që ka qenë fallc. Edhe unë vetëm kah pamja që jom dukë pak me flokë t'gjata kështu si pata fillu m'i rritë floktë edhe nga fakti që unë isha, për shembull, nga Klina edhe saherë ka ndodhë m'kanë nalë iu kom thanë, "Jom ardhë ktu në vizitë te daja në Prishtinë". S'ju kom tregu që jom student edhe kanë besu.

Ndërsa ka ndodhë që me dokumente identifikimi t'vet i kanë rreh policia. Për shembull, po flas për atë kohë. S'kom pshtu as unë, por ju tregoj ma vonë. Por, po flas si pasojë e shfrytëzimit t'atij letërnjoftimit nuk kom pasë ndonjë problem. Edhe fillova ashtu, pra studimet e gjuhës angleze. Nuk është që kam qenë ndoshta prej studentëve ma t'mirë, kom qenë mesatar ose ma i ultë se mesatar me studime. Sepse gjithmonë fokusin e kisha te aktrimi. Doja aty.

Pastaj, në vitin '93, në të vërtetë saktësisht në vitin '94, bashkë me vllaznit edhe me ni kusheri tjetër hapëm ni kafiteri në Prishtinë, "Blue Jeans". Edhe aty pra ishte ni kafiteri ku vinin t'gjitha komunitetet. Normalisht, ma së shumti shqiptarë, po turq, boshnjakë, goranë, serbë. Të gjitha komunitetet kanë ardhë. Ishte bash tani ku osht' Bill Clinton, përballë statusë të Bill Clinton, bustit aty. Aty kanë qenë disa kafiteri si baraka edhe aty ka qenë kafiteria jonë. Muzikë kemi dëgju alternativë, hard rock, metal, kështu, ajo m'ka pëlqy. Po muzikën kem dëgju edhe gjana tjera, do t'thotë nuk ka qenë vetëm ajo.

Karakteristikë ka qenë se edhe pse n'atë kohë ishte kohë e vështirë, ne prapë mund t'gjenim edhe, qysh me thanë, mundësi pak për argëtim po, për shembull, kur punonim deri në 11:00 -12:00 të natës momentet e fundit e mbyllim lokalit e vetëm për vete dëgjonim muzikë folklorike shqiptare. Për shembull, Dervish Shaqën, a Bijtë e Sefës, apo diçka të folklorit që kishim dëgju nëpër fshatra. Ne ka ndodhë ksi muzike kemi dëgju.

Edhe ni rast që mund ta përmendi tani, për shembull, aty afër ka qenë ni stacion i policisë serbe, ka qenë Stacioni numër katër, po m' duket atje i Dardanisë. Edhe shpesh herë kanë ardhë policia edhe ne, edhe n'ato kohë t'vona kur ne kemi pasë atë muzikë edhe kemi nalë se jemi tutë, a po kupton. Ka ndodhë ndonjëherë që kanë thanë, "Lene, lene", a po kupton, edhe na, "Ju po preni serbë me këtë muzikë", se ato muzikë janë kanë patriotike normalisht të bazume në tregime, të vërteta, gjana të dhimbshme të shqiptarëve. Por, kangë patriotike që kanë reagu ose vepru kundra regjimit.

Po një prej policëve ka ardhë shpesh edhe ka lypë kafe, sheqer po menoj se ata kanë pasë kafe atje. Përpos që s'kem guxu me ju lypë paret kurrë për shërbimin, qoftë për kafe ose çaj ose ndonjë birra. Nganjëherë kanë ardhë me një filxhan edhe kanë lypë, kanë thanë, "A bon do sheqer se po na vyn për me bo kafe atje", edhe normalisht kurrë s'i kemi kthy thatë. Edhe s'kem guxu, po edhe me guxu na e kem traditë që kur t'lyp dikush diçka t'i jep se nuk ia nalë. Pastaj ma vonë t'ju tregoj se në bazë të ksaj ngjarje edhe ni ngjarjes tjetër atëherë është kriju ni, osht' ni film i vogël, si dokumentar që osht' tani osht' edhe në Amazon që quhet, "With a cup of sugar". Osht' ni filmmaker nga Iowa që e ka ba n'bazë të ktij tregimit tem. Ndoshta keni dëgju ose jo, po mundem me nda me juve ma vonë.

Por, gjatë viteve të studimeve, pra kjo ishte edhe koha kur ishte vështirë t'studioje nëpër shtëpi. Në anën tjetër sepse ishte... u dashke t'shkojmë msheft forcave policore. U dashke të gjarprojmë nëpër rrugica të ngushta të Prishtinës që t'mos ndeshëm me policinë gjatë rrugës. Ka ndodhë plot studentë që janë rrah gjatë rrugës. Unë ma vonë dy herë kam qenë personalisht, vllau im i rrahur nga forcat policore. Po kanë qenë kohë të vështira për t'gjithë atëherë.

Anita Susuri: Në cilin vend ka qenë fakulteti ju? Po mendoj dega e gjuhës angleze?

Xhavit Gashi: Po, dega e gjuhës dhe leterisë angleze atëherë ka qenë e vendosun në dy-tri lokacione. Fillimisht, Fakulteti Filologjik si dekanat që u qujtë atëherë nëpër shtëpi ka qenë i vendosun në Durmitor. Durmitori ni lagje. Po m' duket është bash te ish shpia e Bajram Kelmendit diku aty. Edhe pastaj ma vonë ka qenë, kom harru qysh quhet lagja tjetër te sharra, rrugën kah shkojmë kah lagja, pas shkollës "1 Majit" është ajo, pas shkollës "1 Maji" atje. Edhe në shkollën "1 Maji", nganjëherë e kem shfrytëzu rastin, edhe aty mundem me nda ni storie interesante.

Ka qenë kaniherë diell edhe t'shtunën kur s'kish fëmi na mundemi t'i shfrytëzonim shkollat fillore. Sepse shkollat fillore ende shfrytëzoheshin në disa lokacione nga nxënësit, nuk e pengonin, nuk i pengonin regjimi atëherë shkollat fillore. Zakonisht, çka kanë bo nëpër ato shkolla, shpesh herë kanë çu drejtorë të dhunshëm serbë, po nuk iu ka pengu aq shumë edukimi i fëmive, sa në shkolla të mesme, e dijmë edhe fakulteti. Të gjithë janë detyru t'mbahen nëpër shtëpi.

Aty ni rast është interesant, unë isha student i gjuhës angleze. Normalisht me një pamje krejt tjetër, po kemi qenë dy a tre studentë që kemi pasë floktë e gjata. Po unë ma karakteristik se i kom pasë shumë t'gjata. Edhe ni e shtune po m' duket ka qenë, ata kishin thirrë fëmijtë për disa orë plotësuese në një

klasë edhe ne ishim duke pritë konsultime për ni provim të gramatikës të gjuhës angelze nji. M'kujtohet shumë mirë me profesor Ismail Mehmetin ka qenë nga Tetova.

Edhe ishim t'u pritë për konsultime edhe nga një klasë aty e hapnin derën disa fëmi, dilshin nga dhetë bashkë edhe bojshin me gishtë {shpjegon me duar} nga unë edhe u kthejshin duke qeshë. Edhe interesant ju kom dokë. Ndërkohë vjen ni person i gjatë, thashë me siguri ndonjë msus. Edhe po m'drejtohet mu tha, "Ju", unë nuk e dita çka mund t'jetë. Tha, "Ju", thashë, "Unë?" Tha, "Po". Thashë, "Urdhno!" Tha, "Turp të keni!" Thashë, "Okej, çka osht' kjo turp kështu?" Po e dëgjova, pak nuk m'erdh mirë normalisht e dija se s'kom bo asni veprim.

Tha, "Turp të keni", tha, "si s'keni turp", tha, "si dukeni sikur armiku". Me pamjen time me flokë t'gjata edhe garderoben gjithmonë e kom pasë, për shembull pantollat apo këpucat apo, çfarëdo që kom pasë i kom pasë n'qef ngjyra të ndryshme, shumë ngjyrëshe edhe këpucat me ngjyra i kom pasë edhe iu kom dokë pak ma karakteristik kështu. Edhe thotë, "Turp t'i përngjani armikut" (buzëqeshë) thashë, "Qysh po mendoni i përngjaj?" "Me kto qy qysh po dokesh. Fëmija po mendojnë që është mirë me marrë msim nga ju". A po kupton, në atë aspektin edukativ.

Thashë, "Kërkoj falje nuk jom ardhë kështu, jom ky". Ai ndërkohë ka bisedu me profesorin kur kem shku na. E herën tjetër kishim, po s'kish fëmi, po ai kish qenë prapë aty edhe erdh m'kërkoj falje. Tha, "T'kërkoj falje po na nuk jemi msu me pa qishtu studenta ose njerëz", ose për shembull m'tha, "Po masi kom folë me profesorin Ismail, m'tregoi që je, osht' gjithçka n'rregull, je student i mirë". M'kërkoj falje, mirë u pajtum. As s'e kisha ndërment me bo diçka.

Por, ka pasë edhe gjatë rrugës për shembull t'u shku atje m'kanë thanë, "Ej, a po i hjekë ti qito flokë, a t'i prejme na?" Sepse ju kom dokë tjetër, jo njejtë me pjesën tjetër t'komunitetit. Ma ndryshe edhe kanë thanë, "Çka osht' ky kështu?" Po kanë qenë megjithatë vite të vështira, por edhe vite t'mira.

Anita Susuri: Cilat kanë qenë vështirësitë e tjera me studiu mrena ni dhome? Qysh e kujtoni ju qato? A ka pasë banka? Qysh ka qenë?

Xhavit Gashi: Po, në klasa ka qenë interesant. Kanë qenë disa blloka të ndërtimit me disa drresa përmi, ashtu ka qenë. Por, për neve si nxanës po edhe për mu që kam ardhë prej fshatit nuk ka qenë ekstrem e vështirë, sepse unë jam rritë në kushte të vështira. Ma e vështirë ka qenë për mësimdhanësit. Unë e çmoj punën, kontributin e tyre që n'ato kushte të ligjerojnë ose të msojnë. Edhe për besë e kanë pasë ni përkushtim që une nuk e shoh as n'ditë të sotme atë përkushtim që me të vërtetë të shpërndajnë dijen edhe t'bojnë ni edukim kualitativ.

Unë ta përmenda rastin kur kom shku te ai profesori Ismail Mehmeti aty edhe n'konsultim, për shembull, sot nuk i thrrasin n'konsultim fare ose s'i pranojnë. Ju thojnë, "N'rregull osht'". Nuk kam t'gjitha informatat. Por, e di unë për shembull ishte hera kur ai m'kish, domethonë unë e kisha emrin

prej studentave që unë kom ra prej provimit, por isha shumë i bindur që kom punu mirë n'provim. Unë isha i bindur që s'kom punu për dhetëshe ose nantëshe, a po kupton, po për hajde as për tetshe po për një shtatshe, gjashtëshe gjithsesi po, e disha. Edhe shkova n'konsultime edhe arsyeën pse m'kish rrxu prej provimit ishte vetëm ni pikë. Edhe e kish shkru aty.

Ma tregoi provimin, si e pava *punctuations* [pikësimi], e kish shkru *punctuations*. Si e pava diku ni pikë, tash a në fund të fjalisë apo ni presje, nuk m'kujtohet saktësisht. Po e di që do t'thotë për ni pikë m'ka rrxu prej provimit edhe ai t'ka bo ma të kujdesshëm. Herën tjetër me i kushtu ma shumë rëndësi *punctuations*, jo vetëm *content*, përbërjes edhe formës si ese, por mos me harru edhe ni pikë që osht' kaniherë çështje teknike e vogël. Por, ka qenë, ata i çmoj për punën e tyre n'ato kushte të vështira. Edhe normalisht nuk ka qenë e lehtë edhe për do studentë tjerë, sepse shumica e fëmive atje kanë qenë fëmi të doktorave, të profesorave, që i kanë pasë kushtet shumë ma t'mira se unë. Është e vërtetë se unë n'vitet e fundit, ndoshta katër-pesë vite para se t'vi në studime kanë ndryshu kushtet edhe te unë. Mirëpo, unë kom majtë mend edhe kohën kur kom kalu nëpër kohë shumë të vështira, ku normalisht nuk kom pritë që me i fillu studimet unë nëpër shtëpia private, nëpër aso kushte. Por, ka qenë e përballueshme, ka qenë e përballueshme.

Anita Susuri: Si ka qenë Prishtina n'ato vitet e '90-ta? A osht' vrejt që osht' qytetit i okupum? A ka pasë liri? A qysh e keni vrejtë ju?

Xhavit Gashi: Po. Okupimin e ke vrejtë, për shembull te kufizimet e lëvizjes, kufizimet e qëndrimit vonë. Për shembull, kur ke dalë në lagje të caktume ose kur ke dashtë me dalë me pi bashkë, bashkë me nejtë me ndonjë shok ose shoqe. Për shembull, në ni lagje të caktume kanë thanë, "Ikni se po vijnë të zitë". Domethonë, u dashtë me lanë n'gjyhtë ose muhabetin ose pijen ose nejtën edhe me ikë se po vijnë të zitë. Domethonë, të zitë ka qenë termi për policinë. Ka pasë shumë kufizim, kufizime në liri, të drejtave. Vet fakti që jem kanë t'u studiu nëpër shpia me frikë që çdo moment mujnë me hy policia me të zbulu, me të rreh ty ose profesorin, ka qenë, ka qenë e vështirë.

Anita Susuri: Ju e thatë që disa herë edhe iu kanë rrah.

Xhavit Gashi: Po.

Anita Susuri: Si ka ndodhë kjo? Pse ka ndodhë?

Xhavit Gashi: Po, kjo ka ndodhë, është interesante. Rrahja ka ndodhë dy herë, rrahjet nga policia, një ka ndodhë shumë vonë. Dyjat kanë ndodhë në vitin '98. Njëra ka ndodhë pikërisht me 5 mars të '98-ës, kur ne ndoshta kishim ni muj ma herët që kishim bisedu me vllaun e vogël, sepse ky ishte në Kosovë, dy vllëzërit e tjerë ishin në Zvicërr në atë kohë. Kishim bisedu pasi në të vërtetë, pas ramjes së Ardian Krasniqit që ndodhi në vitin '97 e që ne përmes disa familjarëve tonë kishim njohuri, e njëfishim Ardianin personalisht. Nuk e kom pasë shok, po e kom njoftë përmes lidhjes kështu.

Ramja e tij e boni të ditur se Ushtria Çlirimtare ekziston. Pra, është ni lëvizje e gjallë që edhe i kundërvihet forcave serbe edhe me forcë për me bo diçka për shlibim t'vëndit. Ai ka qenë ai turning point [Eng. pika kthyes], ai farë momenti kur ne, unë edhe vllau vogël kemi thanë, “Okej, edhe ne dojmë me kanë pjesë e qisaj lëvizjes me luftu kundraj, kundër atij regjimi”. Mirëpo, saktësisht në shkurt ka qenë, në shkurt të vitit ‘98-të kur kemi bisedu, në të vërtetë jemi interesu fillimisht me vllaun me iu bashkangjitë ndonjë grupi ktu afër.

U folke për disa grupe në Podujevë, për disa grupe në Bellaqevc ose ktu afër, jo larg Fushë Kosovës e Obiliqit. Mirëpo, ne nuk njifshim askë kështu personalisht. E sigurova një armë prej ni daje në Prishtinë edhe fillova me mbajtë me veti ose me të thanë të drejtën planifikoja nëse bash vjen puna deri te konfrontimi isha i gatshëm, domethonë me u konfrontu. Armë kisha. Ajo nuk ishte që ishte një armë kumeditë çka, por ti e llogaritë vetëm që kumeditë çka mundësh me bo se s'kishe as përvojë ushtarake, asgja të baj me siguri.

Mirëpo, në mars, 1 ose 2 mars [1998] vllau ishte në Pejë edhe m'thirri mu, “Xhavit, qitash duhet me ardhë se po m'doket po organizohemi kha”, “Eh”, thashë, “mirë”. Me 5 mars unë e kisha veturën atë kohë, e lashë. Më sugjeroi ni shok, m'tha, “Ma mirë leje veturën shko me autobus, sepse në autobus shansat janë ma të vogla me t'nalë. Atëherë, vetëm ishim kriju këto post blloqet, për shembull në Komoran, në Pejë. Para se me shku në Istog ishin dy-tri post blloqe që ishin. Nëse shkon me veturë ti s'kishe pshtim pa u nalë prej forcave serbe.

Mirëpo, me autobus thanë zakonisht nuk po i nalin autobusat edhe shkon ma lehtë. Okej, u nisa nga Prishtina, në Komoran na nalën mu edhe njo tjetër, edhe dy vetë tjerë. Po m'duket kanë qenë edhe ishte 5 marsi, nuk isha idenë as informacionin se çfarë po ndodhë në Prekaz fare. 5 marsi ka ndodhë me familjen Jashari. E shihnim që ishin tmerru forcat serbe aty, u nijshin të shtëna, a po kupton. Po ne nuk kishim informacion se atëherë s'kem pasë telefona ose diçka. Kur ke hypë ti n'autobus ma s'ke pasë ma informata, ku me i marrë informatat.

Kur shkum në Komoran ata i pamë edhe hynin n'autobus ata. Për shembull, mu, ata, “Këta tre, jashtë autobusit”, i tha, “shko ti”. Edhe neve na nxerrën na futën aty në post bllok edhe unë e dita që me siguri tash t'gjitha ato t'shtëna që i nijshin përreth, tash s'disha çka ndodhë po garant na krejt menum që kanë me na vra se s'kish tjetër mendim. E s'kishim na kurrfarë fuqie, kurgjo me veti. Ata meniherë fillunë me na grushtu, me na rrah kështu fuqishëm shumë.

Edhe ndërkohë njani prej tyne t'u më sjellë kështu me boksa me shkelma edhe i ra pak maska, se i kishin disa maska kështu në ftyrë {me duar shpjegon formën e maskës}. Jo si këto tash me covid. Po maska pak kështu të ftyrës. Edhe unë isha ma shumë se 90 përqind i sigurt që ishte njani prej atyne policëve që vinte me marrë sheqer n'kafiq te unë para disa vitesh. Edhe i thashë, “Ti je Dragani”, serbisht. Tha, “Jo, nuk jam” edhe filloi me më grushtu papë.

Mirëpo, na rrahën edhe pak edhe dikur u nalën. Ai kish, diku i kish thanë autobusit me u ndalë edhe unë isha i përgjakur a kupton. Floktë m'u kishin shkapërderdhë, floktë e gjata. I kisha ni xhakëtë të verdhë, të sarit që thojshin përpara, e verdhë kështu, edhe ajo ish bo pak me gjak këtu {prek duar te gjoksi}, domethonë isha gjakosë. Edhe m'tha, "Hajde", tha, "ktu. Aty n'dalje autobusi po ju pret". Na qiti treve aty edhe m'qiti m'i la sytë. Tha, "Heke gjakun e këto mos të doket", edhe u çudita. Po ai nuk e pranoi që osht', po unë kom mendu gjithmonë që ai ka qenë edhe prapë... edhe pse ka qenë pjesë e regjimit, ka qenë ai elementi human njerëzor që osht' ardhë aty ka marrë sheqer, e ka pi ndonjëherë ndonji kafe.

Edhe kom mendu që ai ka qenë faktori kyç pse atë ditë neve s'na kanë vra. Se neve na kishin vra, ashtu kom menu edhe kom dashtë me besu ashtu, se du me besu prapë në vlera njerëzore. Ti mundesh me kanë pjesë e një regjimi po edhe unë me kanë pjesë e kumeditë çfarë urdhërave nuk boj urdhëra bash gjithçka që urdhërohna nëse nuk osht' në vlerat e etikës, moralit apo asaj që unë besoj që osht' e drejtë me ba. Unë qashtu kom dashtë me mendu për ta. S'ka qenë asi fare, po për atë moment unë ashtu kom mendu.

Edhe, "Në rregull. Hyp n'autobus". Kemi shku edhe diku kom nejtë ni muj në Studenicë. Atëherë n'mramje ndëgjum për rastin që ka ndodhë edhe u mblodhëm me ata dy-tre veta që ishin si celulë e bashkësisë lokale për organizim me UÇK. U takova me ta, "Çka po bajmë?" A kupton, thanë, "Na kemi urdhër", se na ishim pjesë e Dukagjinit. Zonë operative e Dukagjinit edhe nga shtabi i përgjithshëm që kjo zonë të ruhet për shkak të furnizimit me armatim nga Shqipëria edhe nga Mali i Zi, sepse ne ishim n'atë tre kufirin, pjesën e tre kufirit ku lidhet Kosovë, Shqipëri, Mal i Zi.

Edhe tha, "Kemi interesim që t'jetë e hapur për shkak të furnizimeve dhe nuk bon t'marrim asni aktivitet edhe nëse na vijnë serbtë n'anën tonë". Pra, nifarë forme u tha që na s'guxojmë t'organizohemi si të hapur, të identifikohemi edhe t'mos marrim ndonji veprim as ndaj forcave serbe nëse vijnë aty. Edhe pse ne nuk ishim shumë, atëherë i blejmë disa armë, po ato ishin disa kallashnikovë, ndonjë pushkë gjuetie, ndonjë revole, një bombë, granatë dore. Nuk kishim ndonjë armatim t'madh. Por vullneti për me bo diçka kundër armikut ishte i madh për liri, për vend.

Atëherë, prapë bisedum me vllaun, tha, "Ndoshta është më mirë Xhavit", tha, "me shku ti në Prishtinë, se ktu munësh me u identifiku tash", se na kishim bisedu me ata njerëzit lokalë. Tha, "Munësh me u identifiku, munët me na dalë telashe me na ardhë n'shpi. Na s'mujmë me nejt pa i gjujtë. E ju bojmë telashe edhe tjerëve". Edhe une erdha në Prishtinë me autobus, do të thotë pas ni muji. Atje situata pak, në Prekaz u ditë që s'ish ma nejtë ose n'gjana tjera. Kish disa raste tjera.

Jom ardhë në Prishtinë, kom nejtë disa muj. Në qershor domethonë mas datëlindjes me 29 qershor unë e kom pasë ni lloj betimi me disa shokë, shoqe këtu në Prishtinë, që unë tash përfundimisht po du me shku ma atje. U zgjerunë zonat e luftës, u zgjerunë edhe thashë, "Prej sot unë zyrtarisht do t'jem

kudo që t'mundem du m'u kyç". Qoftë, atëherë dishim pak për Glllogjan te Ramushi apo në zona ma t'afërta ishin disa fshatra në lug të Drinit, i qunim ne si i dinim disa celula.

Mirëpo, i identifikum disa persona ma shumë edhe në fshatra tona, unë thashë, "Do t'jem pjesë e tyne". E fola pak kështu. Betimin e bona me flamur e kështu edhe atëherë ishin krejt studenta, shokë t'mi shumë të mirë. Njo prej tyre nuk e harroj kurrë ishte djali i vetëm i familjes tha, "Po du me ardhë me ty", thashë, "Nëse i tregon ti babit, mamit tond", se ishte djalë i qytetit e me bab e mam, jo me nanë si unë (qeshë). Edhe i thashë, "S'ka problem. Hajde, po une duhet m'u taku me prindtë tanin me ditë që ti po vjen me mu". Tha, "Jo, ata s'më lajnë veç kështu, a kupton, nuk m'lojnë", "Atëherë", thashë, "jo, mos hajde".

Edhe atëherë pra kom vendosë me shku kah Mitrovica kah Rozhaja atje edhe m'u kthy n'fshat timin. Për mos me shku knej, se prapë knej e kisha provu ni rrehë, e nuk besojsha me shku ma knej. Ma mirë po iki anej te Mitrovica, m'thanë kalon ma lehtë. Edhe me t'vërtetë nuk na nalën policia në Mitrovicë në autobus. Kur kom shku në Podgoricë, për shembull atje i kom taku edhe disa qytetar që kishin ardhë me ble mallra për shpi, sepse furnizimet u vështirësunë. Për shembull, te na në Istog atje edhe na bonim tregti edhe me Malin e Zi, nuk ish shumë larg prej neve.

Disa prej atyre blerjeve ose transporteve u bonën përmes maleve, bjeshkëve. E ni djalë i fshatit tim tha, "Xhavit mos shko se atje te na", tha, "e dijnë që ti je pjesë e qitij organizimit te na edhe mujnë me t'nalë policia edhe munet me t'dalë telashe". Për fat t'keq timin ishte ni drejtor i ni kompanie Kollçaku, kompani turistike në Pejë edhe ai m'tha, "S'ki nevojë me shku n'kamë", tha, "Unë i njoh policinë tanë, vi çdo ditë", tha, "unë duhet me iu ble cigare, duhet me ble dreka, darka gjithë. Për çdo ditë iu blej atyne", tha, "edhe m'ju thanë atyne që t'kom ty shok e t'njoh". Ai mu m'njofke për shkak që i kishim ble bileta për motrën, për vllaun, për ata, krejt që kishin shku jashtë. M'njofke mu. Edhe m'tha, "Mos e ki dert".

Edhe unë nuk isha i përgatitun shumë fizikisht, për shembull sikur u bana ma vonë për me shku maleve, sepse pi ni studenti disa vjeçarë në Prishtinë, në kafiteri, nuk isha as përgatitje fizike. Qysh me thanë, të gatshme që unë t'shkoj maleve. Edhe m'pëlqej me shku me autobus, sidomos e kisha nifare garancie ai personi që m'thojke. Po nuk ndodhi ashtu. Kur shkum në Savina Voda, quhet vendi masi hyn në Kosovë prej Rozhajës, prapë na nalën aty dy veta. Edhe një rrahje tjetër nga një, ai ka qenë krye kriminel, ma vonë i vramë prej ni shokut tim gjatë luftës. Por, ai ka qenë aty. Mirëpo, atë ditë ajo ka ndodhë edhe aty kom pasë dy-tre brinjë të thymë e kështu. Por, ata interesant nuk kanë pasë as ata ndonjë informacion, për shembull për mu po vetëm na kanë nxjerrë *randomly* [pa ndonjë paramendim] a p'e di, "Nxjerri ni, dy, tre veta prej autobusit. Ti, ti, ti".

Anita Susuri: N'autobus djemtë e ri i kanë nxjerrë a veç qysh ua ka marrë menja?

Xhavit Gashi: Po mu ma merr menja që, po djem t’rinjë edhe qysh ua ka marrë menja, a po kupton. Une, qysh me thanë, unë mendojsha pak ndoshta stili jem nuk i len ata se thojnë ky s’osht’, ky s’ka t’boj kurgja me ushtrinë. Me t’vërtetë jom kujdesë shumë, për shembull gjithmonë prej momentit që kom fillu m’i rritë floktë jom kujdesë me çka po di, me shampona t’mira me garderobën e kom pasë ma ndryshe. Kështu ni stil ma t’veçantë.

Edhe kom mendu s’ja u mbushi mendjen atyne edhe shpesh herë me kerr, për shembull në Prishtinë kur kanë nalë i kanë nalë shumicën e njerëzve pa m’njofte hiç, mu m’kanë lëshu se kanë thanë, “Hajt se ky s’osht’ i ndonji pune të hajrit për vend. Garant kanë...” unë ashtu kom menu që ata menojnë që si t’më shohin me flokë t’gata, nganjëherë pak pa rru kështu me ni laramani t’garderobës nuk ia kom mushë menën për me kanë dikush që i del zot venit. Edhe aty kom menu që as s’iu shkon menja, a kupton. Por, jo aty të zgjedhë qashtu edhe të qet të rreh. S’ki çka m’i bo.

Anita Susuri: Ju jeni lëndu qishtu mas rrahjeve e këto, që i keni pasë britë e thymë e...

Xhavit Gashi: Po.

Anita Susuri: Ku ju kanë dërgu? A ka pasë njerëzit që kanë punu nëpër privat apo?

Xhavit Gashi: Ka pasë, për shembull, mjek që janë kanë, për shembull, t’lagjës janë kujdesë po rentgen s’ka pasë, a po kupton. Unë e kom ditë ose n’bazë t’prekjes t’disa doktorëve kanë mujtë me verifiku se i paske, “Dy ose tri bri valla të thyme”, ose normal t’u pa që m’u kanë thy dhomtë ose diçka. Ato jonë kanë të ditura, të dukshme. Mirëpo, nuk kanë, nuk kem pasë ku me shku. Se me shku në Pejë, për shembull meniherë ke mujtë m’u arrestu. Osht’ rasti prapë i bashkëluftëtarës Myrvete Maksutaj që osht’ vra në Pejë, osht’ dëshmore që ka shku me nxjerrë njanin prej shokëve që ka shku për trajtim. Për shembull, n’spital.

Anita Susuri: Ishit t’u na tregu për spitalet këtu...

Xhavit Gashi: Po. Pra, mundësitë ishin të limtuara që të shfrytëzojmë na spitalet, sepse sidomos kur ishe i identifikum që ti je pjesë e atyne celulave të para të UÇK-së, pra ke qenë n’atë kohë i trajtum si terrorist prej regjimit. Pra, nuk kem pasë mundësi edhe qe fakti është interesant që vetëm dy ditë pas atij vendimi që unë i kisha britë e thymë u dashtë me shku, u dashtë, normalisht unë kom shpreh interesimin vullnetarisht me shku në Shqipëri, me sa orë n’kamë për aramatim.

Do të thotë, vetëm dy ditë pas rrahjes të fundit që i kisha edhe britë e thymë edhe me gjithë ato lëndime, murëm rrugën për me shku për furnizim në Shqipëri. Krejt rruga ishte n’kamë. Diku dy ditë me shku edhe në kushte të vështira. Për shembull, edhe në Shqipëri u dashtë t’flejmë nëpër oborra të shkollave, në si lloj shtallave, në ambient të hapun. Vetëm me disa ditë m’duket shumë pak ditë kemi mujtë t’flejmë mrena diku me ni shpi që na ka strehu njo vendas i Shqipërisë, ni kryeplak.

Përndryshe, krejt u dashtë në kso kushteve. E për mu përpos tana ktyne vështirësive, normalisht që kishim problem ushqimin, shqetësimi që s'kem armatim me u furnizu e me u kthy në Kosovë n'luftë. E unë atëherë kisha gjithmonë e kom pasë brengën edhe të flokëve, papastërtia, a po kupton. Edhe normalisht që u dashtë të kujdesëm. Nuk kom dashtë m'i hjekë edhe pse atëherë osht' kanë shumë e vështirë edhe u dashtë kur t'kthehem prej Shqipërie me më ndihmu motra jeme edhe ni kusherinë tjetër me ripastru floktë, se janë flliqë floktë në atë kohë pa pastru, kur jom kthy n'shpi.

Po s'kom dashtë asniherë... i kom dashtë floktë. Nuk është veç m'i pasë, po edhe i kom dashtë kështu. Edhe pastaj kur jemi kthy prej Shqipërie ,dy javë ose ma shumë na ka ra me prit në Shqipëri për armatim me ato kushtet të vështira që nashta kanë qenë ma të vështira, sesa ktu n'luftë kur kem qenë. Ato ditë në mungesë të kushteve edhe të gjitha. Diku 24 orë kemi bo me armatim, mos me thanë, saktësisht nuk mundem me ditë peshën, por dy ose tri armë në shpinë, ni pako të municionit, a diçka që ka mujtë me arritë 30-40 kilogram peshë.

Prej asaj, domethonë t'merr gjumi edhe t'u ecë me lagështi me natë pa gjumë, gjithmonë n'rrezik se munesh m'u vra. Fatkeqësisht qysh na u kanë vra shumë shokë. Edhe ai që ishte si regjisor ose filmmaker ose si te quj, ai që na organizojke për ato dramet amatore, shfaqjet amatore ish vra vetëm ni ditë para se unë t'shkoj për armatim. Ish vra Nazmi Muslija ai osht' edhe tash dëshmor.

Domethonë, shumë njerëz na u kanë vra në atë udhëtim të cilin e kem ba. Mu m'ka ra një herë në Shqipëri, pra në asi rrugëtimi edhe dy herë nëpër Mal të Zi në asi rrugëtimi. Pra, nëpër borë, nëpër shi, nëpër erë, nëpër... këto, sfidat që jemi përballë sido që të jenë. Pastaj, po unë kom qenë pjesë e brigadës 133 Ardian Krasniqi, pra në rekrutimin e parë e kom ba në Glllogjan, kur jemi shku për armatim që ka qenë fillimi i korrikut po m'duket, ashtu diçka.

Ndërsa, na atëherë s'ka ekzistuar brigada jonë. Më vonë është kriju brigada jonë edhe jem ba pjesë e brigadës 133 Ardian Krasniqi me seli në fshatin tim në Studenicë. Fillimisht celulat e para administrative për organizim të brigadës janë kanë në shpinë time edhe në shpinë e axhës tim. Pastaj jemi zgjeru edhe me ni shtëpi tjetër e një plaku të Ramë Sokolit, atje n'fshat. Edhe përfundimisht edhe pse kemi ekzistuar formalisht, Brigada 133 Ardian Krasniqi themelohet me 10 janar të '99, pra më vonë themelohet.

Edhe aty kom pasë rastin që në shpinë time, domethonë planifikimet edhe për operacione, aktivitete edhe për aktivitete ushtarake, por edhe për mbrojtjen e popullatës civile, organizimin e... sepse kishte ni numër t'madh të dislokuarve, jo refugjatë, por njerëz që ishin të dislokuar nga një zonë në zonë tjetër. Kryesisht në atë kohë ishin largu njerëzit nga fshati i Istogut edhe Pejës edhe kishin ardhë në fshatrat ka na.

Na ishim ma afër maleve që ishte ni mundësi ma e lehtë nëse na sulmojnë edhe nëpër fshatra policia edhe ushtria serbe atëherë të marrim malin edhe t'dalim në Mal të Zi, ku gjenim strehim shumë... edhe unë, edhe familja ime kur kem pasë sulmet në prill, që na u kanë vra shumë prej shokëve tonë që tash janë dëshmorë, atëherë familjet janë detyru t'ikun përmes maleve, bjeshkeve në Mal të Zi në një kohë të vështirë me borë.

Pra edhe familja ime, nana edhe motra edhe një mesë edhe ajo gruja axhës që tregova që ka jetu edhe pasi ka vdekë axhi, kanë shku në Mal të Zi.

Pjesa e Tretë

Anita Susuri: Si kanë qenë këto aksionet? A mundeni me na përshkru pak përjetimin e ju?

Xhavit Gashi: Po, për shembull, aktivitetet e mia të drejtpërdrejta nashta n'luftë kanë qenë n'vijën frontale në Vrellë. Aty kanë qenë aktivitetet. Ndërsa nuk jom i shquar për aksione të veçanta ose sikur kanë qenë disa djem të ri. E përmenda, për shembull, Avni Elezin me një grupacion të djemve, ata kanë arritë me shpartallu pra jo vetëm kryekriminelin po edhe celulën kryesore të bandës të tij që kanë bo krime nëpër Dukagjin, Shaip Uka ni grup tjetër.

Pra, unë i kom njoftë edhe nëpër vija të frontit ata djemtë, po nuk kom qenë prej atyne djemve që me të vërtetë unë jom krenar që i takoj asaj gjeneratës që i kom njoftë, kom pasë rast. Fatkeqësi që nuk jetojnë ma. Por, unë, po, në vija frontale në Vrellë ato dy-tri ditë kritike. Pastaj, po ka raste kur pas ni kohe kur jemi tërhykë nga ajo zona jonë, fshatrat, Studenicë, Vrellë pas ofenzivës t'madhe serbe. Pas një kohe kur jom kujdesë edhe për t'plagosun, për shembull në bjeshkët e Kaliqanit, Jabllanicë, atje kah Peja, Istogu-Peja.

Neve na kanë sulmu prapë 3000 deri 4000 forca. Nuk kanë ditë çfarë numri jem. Na ishim vetëm 110 veta, po kanë ardhë... ni numër i madh i forcave u informum që janë diku 3000-4000 forca, na 110 vetë. Ato forca ishin nga Serbia edhe Mali i Zi, prej bjeshkëve vinin edhe qëllimin e kishin se çfarëdo që të gjojnë. Poshtë ma veç ishin forcat serbe, mirëpo prej bjeshkës kanë menu që jem ma shumë edhe do t'vijmë prej naltit.

Atëherë ne jemi detyru kur jemi lajmëru, m'u zhvendosë. S'pari m'u siguru që të plagosnit t'i shpëtojmë edhe jemi shpërnda. Disa prej neve, për shembull prej brigadës tonë janë vendosë në disa fshatra nëpër Istog edhe lug të Drinit. Ndërsa, unë me ni grup tjetër kemi shku edhe i kem dërgu të plagosurit, po edhe jemi lajmëru në shtabin e atëherë të Zonës së Dukagjinit në Maznik, ku ka qenë komandant Ramush Haradinaj.

Mirëpo, unë aty me grupin tim më është thanë që duhet t'pres një moment kur unë do t'marrë një urdhër dhe t'kthehem prapë në kufirin me Malin e Zi. Prapë në fshatrat, përmbi fshatrat tona. Edhe ishte detyrë që unë nuk e dija çfarë t'bëj. Po m'u tregu domethonë vetëm ditën kur e mora urdhërin që t'nisem, atje do t'takohem në ni pozicion të caktuar që e njifsha unë me një person, oficer, zyrtar i UÇK-së, atëherë që ishte organizu i angazhumë, i ngarkum me detyrimin e furnizimit me armatim.

Pra, na u dashke të kujdesemi që t'i marrim armtë prej tyre edhe t'i përcjellim deri prapë deri në Maznik ku ishte ai. E osht' normal që kemi kalu nëpër shumë prita, nëpër shumë caqe t'rrezikshme. Por, për me përmend, ndoshta për me veçu osht' momenti bash n'ditën kur ne jemi gzu që kemi marrë atë furnizim me disa municione edhe armatim, plus ni sasi të uniformës. U bonëm gati me përcjellë, se sasi të ishin t'limituara po kish ngarkesë t'madhe t'municionit edhe ne u gëzuan shumë.

Edhe mbi fshatin Kaliqan, aty ka qenë ni djalë i fshatit Kaliqan, ni ushtar, fatmirësisht jeton. Ai i njifke ato rrugë, sepse kishte qenë bari ishte kujdesur për bagëtinë përpara asajde në ato bjeshkë, në ato male. Edhe tha, "Une e di rrugën, unë po pri deri të dalim në rrugën që lidhet me fshatin tjetër". Për me vazhdu, për shembull kah fshatat e Pejës pastaj fshatrat deri ku t'lidhet me fshatrat tjetra që ishin grupacionet, grupet tjera duke pritë që ne të dorëzojmë municionin, armatimin, dhe pastaj të kthehemi prapë t'marrim sasinë tjetër.

Ai ka qenë, për shembull, duke ecë, duke pri kur ni moment e ka pa, ka qenë pak pa u bo terr kështu mramje e ka pa disa gjethe edhe disa konzerva. Gjethe të kputura rishtazi pak të lagura kështu edhe konzerva, birra në një vend. Ai sen për neve si shenjë që aty mund t'jenë forcat serbe afër, se ne s'kem pasë as konzerva as birra. Edhe pse ne kemi bo nifarë vështrimi ditën mos ka ndonjë forcë, po nuk kemi pa n'atë farë perimetri.

Po n'kohën prej momentit kur nuk kemi bo vëzhgim edhe jemi nisë na me shku deri aty, aty vetëm kishin pasë ardhë disa forca serbe afër. Aty meniherë ka qenë edhe ni rimorkio i ni traktorit, se kanë qenë shumë traktora, rimorkio nëpër male që kanë provu njerz të me ikë, deri sa naltë mujnë me ikë edhe i kanë lanë ashtu. Edhe aty e kem pa atëherë si kem dalë pas asaj rimorkios, për shembull e kom nalë këtë djalin, Sadri quhet ai djali. I kom thanë, pa zo, veç i kom bo me shenjë që t'jenë të heshtun.

Aty me mu ka qenë edhe vllau im Sadriu, dy ushtarë tjerë, Xhevdeti edhe s'di kush, ia harrova emrin. Veç iu kom thanë atyre që t'presin aty. Kom dalë para asaj rimorkios edhe menjëherë jom ballafaqu me katër-pesë veta. Fati i mirë osht' që kom pasë ni armë që kanë qenë, e qujshim top dore edhe ajo m'ka shpëtu meniherë. Është shumë interesant se është hera e parë që unë kom gjyjtë me atë lloj arme, ka funksionu edhe kemi pshtu na atë ditë.

Të njejtën ditë prapë edhe pse u ardhë përforcimi na u dashtë me gjetë ni rrugë tjetër që t'sigurohem që ai armatim shkon prapë n'destinacionin e duhur. Ndoshta nuk kom shumë storie të aksioneve ose diçka kështu...

Anita Susuri: Po du me ju pytë...

Xhavit Gashi: Po.

Anita Susuri: Çfarë ndjenje ishte ajo me e pa dikon që po vrahët? Domethonë n'rrezik nonstop që ki me u vra ose... çfarë ndjenje osht' kjo?

Xhavit Gashi: Fati i vetëm osht' që kom qenë 24 vjeçar. Për shembull, kur je... sepse kur nuk e ki mungesën, kur e ki mungesën e njohurisë ushtarake, të sigurisë, të mbrojtjes, pra ne nuk ishim t'pregatitun për ushtarë. Për faktin që ju tregova se e gjithë jeta ime ishte e organizume në rreth, një tjetër *lifestyle* [stil të jetës], një jetë tjetër. Pra, nuk kisha ba kurgja edhe pse gjithmonë ato ndjenjat kombëtare kanë ekzistun n'mu me ba diçka për venin, po nuk kemi pasë mundësi t'bjajmë ndonjë trajnim apo përgatitje për luftë, as fizike po as ndoshta bash ashtu...

Unë s'kom qenë as djalë problem, për shembull, m'u rreh me njerëz ose m'u, a kupton, sepse dikush ka qenë vet prej natyrës ma asi. Por, fati i mirë është që kam qenë 24 vjeç, kom qenë ma i përgatitun, po mendoj i pjekun në aspektin e përgjithshëm edhe gjithmonë i falënderohna edhe edukatës të babs. Pastaj, ti e kupton misionin, misionin e luftës e domethonë aksionet e veprimet e tua në luftë ti nuk i lidh me vrasje, ti i lidh me mbrojtje. Për shembull, unë tregova unë kom shku në vija frontale, na jemi mbrojtë edhe e kem ditë që prapa vetës kemi me mijëra njerëz civilë që janë t'u gëzu që na jem, për shembull, jem aty n'front edhe as ata vet as na s'kem ditë që na s'kem aq fuqi t'madhe me bo atë mbrojtje.

Fatkeqësisht, u pa që ne s'kem pasë fuqi me mbrojtë mijëra [njerëz nga] masakra, dhunime. Na kem pasë vullnet t'madh me bo diçka për vendin, por s'jemi kanë t'pregatitur për atë punë. Nuk kanë qenë të lehta. Tash fatkeqësia tjetër osht' pas lufte që nuk ka pasë as institucione shtetërore që t'mirren me njerëzit që kanë kalu nëpër luftë e sidomos për ata t'ritë që kanë qenë 16-17 vjeçarë. Për shembull, edhe për mu osht' e vështirë, po unë 24 vjeçar. Ti nifarë forme, mu nuk m'ka çu as baba, as nana me zor me shku n'luftë, as nuk kom hi për shkak që jom kanë i ri edhe nuk jom hi n'luftë për ni avanturë.

Nuk po di a muj me spjegu mirë avanturë, shumë t'ri, për shembull i kemi pa me rastet e njerëzve që kanë shku në ISIS që ju kanë bashkangjtitë. Disa prej tyre, janë ba hulumtime botërore, që t'ri vetëm kanë dashtë me ni vetën që *they are doing something cool*, bojnë diçka, a po e din, interesant, luftojnë, mysin, vrainë prej lodrave. Na s'kem pasë as asi lodrave për shembull. Po na kem ba diçka për patriotizëm, për arritjen e një drite, me dalë nga një terr, mos me thanë shekullor, po me dekada tëra për shembull.

Na tregum rastin, për shembull, bisedova për babin, babën tem ose vllaun. Po gjeneratat edhe para tyre çka kanë, për shembull vujtë çfarë sfida e sakrificë kanë pasë me mrrri n'këtë ditë. E kështu që, nuk

fokusoheh te ai momenti, qysh me thanë, i drejtpërdrejtë i vrasjes. Ti je në mbrojtje, domethonë nuk ish synimi... dhe në luftë na nuk kemi shku, për shembull unë po flas për vete, nuk kom qenë as pjesë e aksioneve vec t'shkojmë të vrasim dikon ose veç t'shkojmë te sulmojmë ni njësi. Por, unë kom qenë pjesë e atyre... që i çmoj ata që kanë shku, sepse ajo u kanë mision i luftës tonë, m'i neutralizu forcat armike.

Po unë, për shembull për veti ma shumë jom kanë i frontit edhe i menaxhimit të situatave ku bjen në pusi, në pritë, edhe ti duhesh m'u gjindë. I gatshëm pra jom kanë për me shku bashkë kudo. Jom, qysh me thanë, i lumtur që i takoj asaj historie, po une e di se ajo është histori. Vet fjala histori tregon që osht' diçka e kaluar edhe s'jom marrë kurrë, për shembull me atë punë. Për shembull, deri vitin e kalum as s'kom pasë ndonjëherë librezë të veteranit as s'më ka interesu. Tash jom dalë në pension, po, a po kupton. Po gjithmonë mas luftës jom fokusu, çka t'bojmë ma shumë që t'arrijmë? U ditë që ajo osht' kohë që i takon historisë.

Anita Susuri: M'tregutë për disa aksione që i keni, domethonë për aksione që keni pasë...

Xhavit Gashi: Aktivitete, po.

Anita Susuri: Aktivitete. Po kur ka ndodhë çlirimi, si e keni kuptu ju këtë? Ku keni qenë ju?

Xhavit Gashi: Po. Aktivitetet e fundit që përmenda që ishin ato t'furnizimit me armatim, pra unë kryesisht m'ka ra me u marrë edhe me logjistikë për një kohë në brigadë dhe me rekrutim. Por, prapë, ditëve të fundit t'luftës m'kanë qitë pra pikërisht në furnizim. Që u ktheva nga Mazniku atje edhe ishte fundi majit fillimi qershorit. Edhe tash ishte fillimi qershorit kur vjen furnizimi i dytë apo i tretë nëse nuk harroj, bashkë me furnizim erdhën edhe dy gazetarë Newsweek, osht' revista Newsweek, njihet në botë edhe Sunday Telegraph nëse nuk gaboj. Kanë qenë tre gazetarë nga këto dy medime.

Ata kishin edhe, kishin telefona satelitorë, mundësi të lidhjes në internet n'atë kohë edhe ne morëm... edhe para se t'vinë ata, ne kishim mundësi përmes disa tranzistorëve nganjëherë t'marrim informacione edhe komunikimet, kishim telefona satelitorë apo radio lidhje. Kishim. U shpërndajke informacioni rreth bisedimeve, orvatjeve për gjetjen e një marrëveshje për ndaljen e luftës, a po kupton. Po saktësisht pra n'atë kohë na ishim n'atë misionin e furnizimit me armatim se nuk e dishim saktësisht edhe pse u flitke që mund t'ndërpritet lufta, mund t'arrihet një marrëveshje, mund t'hyjnë trupat e NATO-s.

Pra, po neve na gjeti pikërisht pra mbi fshatrat e Istogut e të Pejës atje t'u pritë pjesën tjetër të furnizimit. Pra një nga ato furnizimet na ka ardhë bash atë ditë kur kanë hi forcat e NATO-s. Pra, qysh i kemi pa? I kemi pa, i pritshim, tashti ne dëgjum për marrëveshjen, po i kem pa helikoptertë e parë, na e kem ditë që s'janë të serbëve, sepse serbtë nuk guxonin edhe pse kishin helikopterë, nuk guxonin në

ato zonat malore sepse kishin frikën që ne i gjujmë. Nuk e dishim ku jem, kishin frikë. Edhe ka pasë edhe helikopterë që nashta janë rrxu bash prej gjujtjeve t'ushtarëve tanë, edhe e dimë që ka pasë.

Po kur i kem pa helikopterët me ni numër ma t'madh nga ajo zonë në Banjën e Pejës atje, që ka qenë nja pesë-gjashtë kilometra vijë ajrore ne e ditëm, a po kupton, që kanë ardhë trupat. Pastaj, jemi mundu të afrohem, të bisedojmë me ta, t'ju tregojmë që ne jemi ktu. Po kanë qenë edhe ata gazetarët prezent me neve. Tash ka qenë ni ndjenjë shumë interesante, a po e din, me pasë atë ndjenjën që tash u kry lufta. Mirëpo ka qenë kohë e rrezikshme sepse ende ke pasë aty-ktu forca serbe derisa janë evaku.

Pastaj janë kthy popullata me ni eufori shumë t'madhe edhe kthimi ka qenë i menjëhershëm. Ka pasë pastaj fatkeqësisht, prej krejt asaj që ka ndodhë nga regjimi serb, pastaj kur janë kthy njerz të nuk kanë pasë kurgja, ju ka mungu çdo gja. Edhe njerëzit prej karakterit ndryshojnë, për shembull, dikush ndoshta nuk e ka ditë që nuk osht' një pajisje apo ni makineri e veta, ka menu që është e veta e ka marrë e ka çu në shpi të vet se ka qenë e ngjashme. Kur kanë ardhë tjetër kanë thanë, "Pse ma ke marrë?" Ka pasë ksi elemente.

Pjesa e parë e vështirë që ka qenë e randë menjëherë për mu mas luftime, ka qenë nxjerrja dhe identifikimi fillimisht i shokëve tonë dëshmorë. Të cilët ne nuk kem arritë m'i tërhjeke prej vendeve ku janë vra fatkeqësisht, edhe kanë arritë forcat serbe m'i marrë trupat e tyre edhe m'i vorros diku ose m'i gjujtë diku. Ajo ka qenë tashti ajo farë kërkesa, hulumtimi jonë ku kanë mujtë me kanë ata trupa, ku kanë mujtë m'i gjetë edhe kem hulumtu, për shembull nëpër varreza të fshatrave përreth po edhe u informuam menjëherë që ishin disa varreza në Pejë, ku vetëm janë me NN edhe ka mundësi t'jenë ushtarë, disa prej ushtarëve tonë. Ndjenja shumë interesante ose që... (qanë).

Ka qenë pra identifikimi, gjetja e trupave fillimisht t'atyne njerëzve ushtarëve, shokëve tonë. Aty kanë qenë edhe organizata tjera ndërkombëtare që e kanë bo hulumtimin, "Mjekët pa kufi" e organizata tjera. Po, për shembull, prej brigadës tonë unë kom qenë edhe një Ramadan Dreshaj është një ushtar tjetër, po ai ka qenë, osht' nashta 20 vjet ma i vjetër se unë, ma i pjekur shumë edhe kem hulumtu nëpër varre. Po kur thashë gëzimin që e kem pasë na vet që i kem gjetë trupat e ushtarëve, po ma interesant osht' gzimi i shprehun i familjarëve kur e kanë gjetë, e kanë identifiku ni pjesë trupit të antarëve të familjes (qanë).

Anita Susuri: Desha edhe me u ndërlihdë, gjatë kohës kur keni qenë n'luftë...

Xhavit Gashi: Po.

Anita Susuri: N'aksionet e juja a ka ditë diçka, juve ju ka ra gati ni vjet me qenë i angazhumë. A ka ditë familja diçka? Ku jeni? Si jeni?

Xhavit Gashi: Po. Fillimisht unë e përmenda që n'shpinë tonë kanë qenë ni lloj celule për brigadën e n'atë kohë unë kom pasë, për shembull, nanën, motrën, ni mbesë edhe na dy vllazën që kemi marrë pjesë n'luftë. Pra, kemi qenë n'shpi. Ato kanë qenë n'shpi kur ne kemi fillu aktivitetet tona ushtarake, e kanë ditë. Edhe normalisht kanë qenë si ndjenjat e nanës, ato janë të frikës, të kujdesit, po edhe të krenarisë se djemtë po dojnë me kanë pjesë e kësaj lëvizje. Po, normalisht këshilla gjithmonë ka qenë, “Runu, kini kujdes!” A po kupton.

Po e kanë ditë çdo ditë edhe kur kom shku në front, nana u kanë n'shpi kur kemi shku në front deri n'momentin kur është marrë ofanziva e madhe. Atëherë e kanë lshu shpinë. Vetëm disa ditë, qysh me thanë, na ka ra me nejtë pa nanën në zonën e Istogut, ndërsa ditë tjera jemi kanë tjetër kah. Por, prej ati momenti kur kanë dalë, na s'kemi pasë ma komunikim. Pra, nuk kanë ditë kurrë. S'kanë pasë lajme, sepse siç e dini ka shumë emra në Kosovë Xhavit Gashi, Avni Gashi edhe kur kanë dëgju që u vra dikun ni Xhavit Gashi, “Mos o Xhavit”. A po kupton, e s'kanë ditë.

Masanej kur janë kthy mas luftës në Kosovë, e kem pasë vendosë brigadën në Vrellë, në fshatin Vrellë. Edhe unë jom ardhë pas ni organizimi aty që kem bo jem ardhë n'shpi se m'tregunë që, “T'ka ardhë motra edhe nana edhe mesa”. Shpija ishte e kallme. E kishim na ni pjesë të shpisë të vjetër ku ish hala mujke me hi dikush, po n'oborr rrishim kryesisht. Edhe disa fotografi muj m'i nda që i kom pru të shpisë të djegun aty [i drejtohet intervistuesës].

Edhe tash mu m'kanë pa, po s'e kanë pa vllaun tjetër që ka qenë me mu sepse ai u kanë në Vrellë atje n'brigadë me detyra tjera. Tash nuk kanë ditë me u gzu as për mu t'u thanë, “Avninë e paskan vra” (qanë). Osh t' edhe kjo një ndjenjë qashtu. Po e kanë ditë gjithmonë ku jem. Nuk e kanë ditë saktësisht ku jem, por e kanë ditë që jem n'luftë.

Anita Susuri: Pas kësaj, ju e keni vazhdu atë rimëkëmbjen, qysh me thanë, keni, si çdokush pas luftës...

Xhavit Gashi: Po.

Anita Susuri: Jeni mundu m'u mbledhë edhe me vazhdu tutje, qysh ka vazhdu? Unë e di që keni vazhdu karrierën ushtarake, pavarësisht që keni studiu anglishtën...

Xhavit Gashi: Po, qashtu. Po, po. Po shumë pyetje interesante edhe me, që edhe ktu ka plot momente interesante për me nda. Kur osht' kry lufta, normalisht unë meniherë kom mendu çka muj me bo në sektorin privat. E kom menu ni kohë që jo osht' shumë vonë për mu që m'u marrë me aktrim. Mirëpo, çka kom mendu nashta, kom mendu të merrem, nuk e kom pasë problem noshta, kom mendu ndonjëherë ndonjë emision televiziv ku muj me bo reklama, shpallje ose kom mendu pak për këtë punë. Po mendoj n'atë kohë, fillet mas luftës. Komunikimin nuk e kom pasë problem, për shembull,

kom mendu që muj me bo diçka me komunikim edhe... po synimin kryesor e kom pasë, i kom pasë dy ose tri provime në Fakultet të anglishtes m'i kry ma s'pari ato, por jo me shtet kurgjo niherë.

Janë kanë disa iniciativa meniherë mas luftës që unë të bahem si zëvendës perfekt a prefekt, si u qujtë mas luftës tash si kryetar komune që i kanë zgjedhë meniherë ato organizime të UÇK-së përpara, unë s'kom dashtë me kanë në Istog. Meniherë kom dashtë me dalë, pra jashtë. Sektori jashtë se unë nuk e shisha vetën në ushtri, me të thanë të drejtën kështu. Edhe ka qenë diku gushti, na e kishim prapë punë oranzative m'u kujdesë për njerëz që kthehen e kështu. Po ka qenë gushti kur ka ardhë në brigadën tonë, komandanti i zonës Ramush Haradinaj edhe na ka majtë ni fjalim, na ka falënderu ushtarëve t'cilët kemi nejtë tonë kohën aty n'luftë për kontributin, për t'gjitha.

Ka tregu qysh ka hi NATO-ja, qysh është, qysh funksionojnë Kombet e Bashkume, qysh ka me u administru Kosova përkohësisht. Nuk ka ditë sa vite, por e ka ditë që do të administrohet disa vite nga Kombet e Bashkume, organizata ndërkombëtare. Ka folë që këta kanë me na ndihmu me bo edhe shtetin, institucionet. Ndër kto institucione ka me qenë ushtria e Kosovës. Edhe m'tha mu ktu tha, "Ushtria e Kosovës, masi s'kemi pasë ushtri përpara, ka me u bo prej ktyne celulave, njerëzve si ju". Tha, "Edhe ju keni dëshmu që i keni dalë zot venit", ashtu kështu, "Po tash çka ka nevojë për juve, me kriju bërthamën e ushtrisë. Normalisht, kjo osht' ushtri vullnetare edhe kush don ka me pasë mundsinë e zhvillimit ushtarak, në karrierë ushtarake". Tha, "Po du me ditë prej juve kush don me kanë pjesë? Kush don me u bo oficer i Ushtrisë të Kosovës?" Edhe tha, "Ata që dojnë, ni hap përpara".

Unë n'atë kohë isha me detyrë komandant kompanie, kisha organizu rreshtimin e brigadës e krejt edhe une nuk dola përpara. Edhe erdh ai, u befasova që ma diti emrin, sepse për mu, për shembull, krejt luftën dy herë e kisha pa Ramush Haradinin, a po kupton. Po nashta për shkak që kom pasë pamjen e kështu ma ka majtë emrin mend. Edhe kurrë s'e harroj, "Pse", tha, "ti Xhavit s'po don?" Thashë, "Komandant, lufta u kry edhe unë i kom disa synime tjera". A kupton, me t'vërtetë kisha disa andrra tjera, nuk dojsa. Tha, "Po, a bon", tha, po edhe ia përmenda qita, "I kom edhe dy a tri provime në anglisht. Du me kry fakultetin, m'u marrë me diçka tjetër".

Normalisht që s'e disha me çka, po me diçka po. "Okej", tha, "a munësh pra, a muj me t'u lutë diçka?" "Çka?" "A munësh me na ndihmu vetëm edhe ni vit?" Edhe meniherë, "Po", kom thanë, "edhe ni vit. Po", kom thanë edhe s'kishim kurgjo edhe shpinë e kishim t'kalltë e si shumica njerëzve. Edhe menojsha që nashta fillimisht unë muj me gjetë ni punë me KFOR, a me organizata ndërkombëtare me anglisht, pak kompjuter disha kështu.

Po tash po m'thotë, "A ka nevojë me na ndihmu diçka?" Nuk osht' që i ndihmoj atij personalisht, po i ndihmoj venit edhe thashë, "Po, po për ni vjet, po mundem", a din. Ish koha e tranzicionit, u dashke m'u kujdesë për qita, n'anglisht quhet DDR⁴, demilitarizim, a p'e din, reintegrim, ç'armatosje. Edhe

⁴ DDR - Demilitarization, Demobilization, Reintegration, program ndërkombëtar i cili ka pasur tre shtylla: Demilitarizim, Demobilizim dhe Reintegrim, dhe është hapi i parë i tranzicionit nga lufta në paqe.

punojshim bashkë me IOM⁵, me organizatën ndërkombëtare IOM. Por, unë isha përgjegjës për brigadë, një sërë aktivitete që me u kujdesë që ky proces me shku mbarë, domethonë u angazhova menjëherë.

Kur kom kalu në atë proces, aty m'u ka ofru ni mundësi me punu për OSBE-në, nuk e di saktësisht m'i kanë përmend 1800 marka⁶, se me marka diçka. S'kisha të ardhuna kurfare, se pa pagesë. Po e kisha marrë si mision tash me kontribu edhe ni vjet. Kom thanë edhe kom me nejtë, a po kupton, qashtu me ndihmu. Edhe unë u caktova menjëherë Oficer Personeli në brigadë, po ju pata thanë që unë floktë nuk i prej, "Une rri, por floktë nuk i prej". Tha, "Okej, qashtu pra rri".

Vendosën që unë qashtu qysh jom me nejt në ushtri. Edhe kurrë nuk e harroj kur e kem bo betimin e parë në shtator të '99-tës, në shtator, si oficer i nivelit të mesëm, kapiten aty u vendos me kanë. Edhe atëherë ka qenë, se Ramushi kaloi në Shtab të Përgjithshëm në Prishtinë, ndërsa komandant zone u avancu Daut Haradinaj n'atë kohë, vllau Ramushit. Edhe ai reagoi, bile tha, "Ti me kto flokë s'bon", thashë, "Nëse s'bon", thashë, "unë po shkoj te shpija". Ndërkohë, kaloi Ramushi, tha, "Unë, unë", tha, "e kom lanë". Bash qishtu ka qenë. Unë meta qashtu, oficer.

I ndaj disa fotografi nga trajnimet e para me NATO-n që i kom ba edhe me organizata tjera ndërkombëtare, për kurset bazike edhe të avancume për oficerë në Pejë i kom kry me italianë, spanjollë. Veç qashtu floktë e gjata jom kanë, se kom menu ni vjet edhe shkoj. Po çka ndodhi masanej, mas, gati pa u bo ni vit, mendova për, mendova që ndoshta është ma mirë me nejtë ma gjatë.

Dy elemente kanë qenë, njo ka qenë komunikimi me familje të shokëve t'mi dëshmor e shumë prej tyre kur iu kom thanë... ata janë gzu që mu m'kanë pa aty, ende n'uniformë. Edhe kur ju kom thanë që, "Une veç edhe ni vjet", ata m'kanë thanë, "Jo ti ki me kanë ktu se kur po t'shohim ty po na doket që po shohim djalin tonë". M'kanë bo diqysh si me borxh edhe normalisht e kom pa nevojën që noshta ka nevojë, n'atë kohë nuk osht' sekret me ditë që pak djem edhe vajza nashta e kanë ditë për shkak të studimeve t'mia në anglisht, e kanë ditë nivelin e gjuhës angleze n'atë formë.

Menjëherë, unë u fokusova te mësimet në kurse të kompjuterave. Vet u regjistrova në ni, atje, si ishte si internet cafe, si klasa nëpër zona që u mbajshin, po edhe shkova n'kurse me KFOR-in. Po ajo ka qenë ni element edhe tjetra pastaj lidhja me Valentinën. U njoftova me Valentinën vendosëm m'u feju, m'u martu edhe atëherë vendosa okej, atëherë me nejtë. Me nejtë n'ushtri me kriju familje. Atëherë duhet me ndrru edhe stilin, i preva edhe floktë. Masanej, u bo ni pyetje, "Kush ia preu floktë Xhavitit? A Valentina? A ushtria?" Kështu, nejse (buzëqeshë).

Edhe vendosa me vazhdu karrierën teme n'ushtri. E pa e ditë sa gjatë, po niherë fillimisht ishin nevojat për departamentin e personelit edhe aty kom hulumtu, për shembull, rregullore ose direktiva të

⁵ IOM -International Organization for Migration, Organizata Ndërkombëtare e Migrimit, organizatë pjesë e Kombeve të Bashkuara.

⁶ Deutsche Mark, valutë gjermane e cila ka qenë valuta e vetme që është përdorur pas luftës në Kosovë para se ta merrte Euron. Vlera e dy markave ka qenë sa një euro.

ushtrive të ndryshme çka bojnë për personel, *human resources* [burime njerëzore]. Pastaj, pas ni viti diçka jom thirrë me shku me hapë, me themelu Kabinetin e Gjuhës Angleze në Prishtinë për Akademinë e Mbrojtjes edhe kam qenë ligjeruesi i parë i FSK-së⁷ ku ju kom jep msim, pra gjuhë angleze oficerëve të ushtrisë, atëherë TMK-së⁸.

Po vazhdimisht çka ka ndodhë me zhvillimin tem n'karrierë, që osht' shumë e mirë edhe mu që m'ka majtë t'interesum, se përpos shërbimit unë vazhdimisht kom pasë trajnim, edukim. Çdo nivel ku kom shku, për shembull, prej Istogut niherë i kom përcjellë të gjitha trajnimet me KFOR-in, pastaj para se me shku në Prishtinë kom shku ni trajnim për IP e Indiana Bloomington në Shtetet e Bashkuara të Amerikës po intenseve program [intenzive] që ka qenë, për nivelin ma të lartë të gjuhës angleze.

Pastaj menjherë si kam shku në TRADOK⁹ kam shku në ni program tjetër prapë në Bloomington, si për *method of teaching*, për metodat e mësimdhanies. Paralelisht me kta kom kry edhe trajnime tjera që kanë qenë për sektorin e sigurisë, qoftë me KFOR-in, qoftë me UNDP, me IOM, me ambasada. Kom qenë pjesë e trajnimeve menjherë me t'gjitha institucionet.

Pastaj 2003-ten jom thirrë nga gjeneral Çeku atëherë si komandant i Trupave Mbrojtëse të Kosovës me shërby si asistent ushtarak i tij. Edhe ai, me t'thanë t'drejtën, as aty s'kom pasë prapë, ka qenë ni moment tjetër kur i kom thanë, "Okej, vetëm p'e themelojmë qit' Kabinet të Gjuhës Angleze, p'e bojmë *fully operational*, operacional edhe unë po du m'u tërhjekë, po du me kanë n'sektorë privat". Sepse atëherë jetojsha në Prishtinë me Valentinën, prapë n'kushte të vështira i kishim vetëm 30 metra katrorë. Diku tetë vjet kem jetu me Valentinën edhe dy fëmi Valën edhe Drinin, niherë me njanin tani na lindi tjetri, por ma shumë se tetë vite kem jetu në 30 metra katrorë, ni banesë t'vogël.

Prapë me mundësinë që gjithmonë majshe me gjetë punë ma t'mirë gjithkund, po dojshim me shërby. Hajt te krijojmë edhe qita, p'e krijojmë edhe qit' kapacitet edhe shkun, për shembull, ato tri vitet si asistent ushtarak i Gjeneral Çekut. Për shkak t'nevojave që kishte shtabi i përgjithshëm, atëherë unë isha i caktum në pesë, në gjashtë detyra tjera. Për shembull, përpos asistent ushtarak, isha oficer ndërlidhës me KFOR-in, oficer ndërlidhës me Policinë e Kosovës edhe të UNMIK-ut, oficer me krejt zyrat ndërkombëtare, oficer ndërlidhës për trajnime dhe edukim jashtë vendit edhe pse ish Departamenti i Trajnimit une u dashke m'u marrë edhe me atë punë.

Të gjitha kto më ofrojshin mundësi edhe të zhvillimit tim, por shumë pak kohë për familjen edhe normalisht kushtet shumë të vështira n'shpi. Nganjëherë s'kishim rrymë me disa javë, sepse s'kishim mjete me pagu rrymën e t'gjitha. Por, në aspektin e përgjithshëm e kishim mundësinë me u ni mirë se ishim pjesë e kontributit edhe kurrë nuk e kisha, jo vetëm s'kisha problem, po kisha mbështetje të

⁷ Forcat Mbrojtëse e Kosovës.

⁸ Trupat Mbrojtëse të Kosovës, të cilat u formuan pas luftës nga njësitet e UÇK-së, si proces i demolarizimit të tyre.

⁹ Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes.

vazhdueshme prej Valentinës që, “S’ka dert që jem na keq, veç vazhdo ti me bo çka osht’ mirë për vendin”.

Në 2006-tën kur Gjenerali Çeku atëherë kaloi u ba Kryeministër i Kosovës, atëherë edhe ai ka qenë momenti tjetër kur kom thanë, “Në rregull tash, unë po dal”. Ka pasë disa iniciativa që unë të udhëheqi Këshillin Kombëtar të Sigurisë në Qeverinë e Kosovës, po me kërkesën edhe të Gjeneral Çekut edhe të Gjeneral Selimit atëherë osht’ kërku që unë t’mbetem si shef i Kabinetit në Shtabin e Përgjithshëm të TMK-së edhe për tri vite tjera. Paralelisht kësaj unë prapë kom mbulu këtë bashkëpunimin ndërkombëtar si për me institucione, me qeveri t’ndryshme, jo vetëm Qeverinë e Kosovës po edhe në trajnim-edukim që kom pasë rastin prapë edhe të përfitoj nga trajnimet, edukimi.

Pastaj në shpërbërje të TMK-së edhe formimit të FSK-së kom qenë si udhëheqës i grupit për formimin e FSK-së nga oficerët e FSK-së, që u kanë ekip i përbashkët me NATO-n. Pra, kom punu n’atë edhe pastaj pas transformimit jom caktu si drejtori i parë i bashkëpunimit ndërkombëtar, Departamenti për Bashkëpunim Ndërkombëtar, ku për tri vite kemi ba edhe dikund njimdhete marrëveshje të bashkëpunimit me shtete t’ndryshme, derisa unë jom kanë drejtor i bashkëpunimit ndërkombëtar.

Në fund krejt pra si pjesë e shërbimit ushtarak, në 2011-ën u vendos që unë të caktohem si atache ushtarak i Kosovës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Edhe ajo prapë, jo sepse unë isha, ishte kërkesë e imja po ishte ni kërkesë e institucionit që na të fillojmë edhe shtetit me atache ushtarake. Edhe ishim në një takim në Departamentin e Mbrojtjes në Pentagon bashkë me ministrin Çeku, atëherë Çeku ishte ministër.

Ndër disa kërkesat që ju bo qeverisë amerikane edhe zëvendës kryetarit të mbrojtjes, Miller quhej, ishte që edhe na të fillojmë me dërgimin e atachesë ushtarake edhe na ta kem. Ai tha, “Po, nëse keni personel të pregatitun, të gatshëm, mund të filloni menjëherë me procedurat”. N’atë takim m’u ka drejtu atëherë ministri ose Gjenerali Çeku, “Po”, tha, “na e kem kolonel Gashin”.

Për shkak të komunikimeve të maparshme që i kom pasë në departament, kom qenë i njohun edhe për stafin e Sekretarit të Mbrojtjes edhe zëvendës sekretarit edhe nifarë forme e kanë konfirmu që me mu munden me ecë përpara me këtë punë. Po nuk ka qenë ndoshta synimi jem, po osht’ ni nderë për mu që jom kanë atacheu i parë edhe jom mundu me ba punën ma t’mirën si atacheu i parë i Kosovës që osht’ caktu për ndonjë shtet. E normalisht, nderë me kanë i pari me ia nisë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Anita Susuri: A keni, për shembull, diçka interesant që ka ndodhë n’atë kohë, n’qato udhëtimet diplomatike që keni shku? Se domethonë osht’ ni shtet shumë, shumë ma i zhvillum se na e domethonë ushtri shumë ma e zhvillume.

Xhavit Gashi: Po, osht', për shembull, për mu, për shembull, kaniherë m'u ka dokë sikur andërr. Normalisht, jom falenderues i brezave tanë që me mundin dhe sakrificën e vet edhe kësaj gjeneratës tonë po edhe atyne ma herët që na kanë mundësu me ardhë në këtë ditë, ku unë kom mujtë m'u konsideru për shërbim ndaj venit po edhe m'i pasë privilegjet me kanë, për shembull, i pari n'atë ose n'këtë punë. Jo për shkak të krejt aftësive t'mia, po ka qenë gjenerata e parë që u dashtë me ia nisë me institucione apo punë t'reja.

Për mu m'u ka dokë shumë si andërr, se unë ni djalë, ni djalë i ni katunit të Studenicës atje ku normalisht jom rritë në frymën e patriotizmit e ardhedashurisë, por as andërr s'kisha mujt... andrra për ushtrinë m'u ka thy në klasë tetë, e kom ditë që nuk ka shansë me kanë. Por, andrra për shërbim m'u ka ngjallë me aktin e lufës me shërby për vend. Po unë kom menu që ai është mision vetëm për shlibrim, por s'kom menu që do t'jem oficer. Aq ma pak që ni ditë unë do t'jem njeri që do t'kem qasje t'plotë në Pentagon, qasje të plotë në Departamentin e Shtetit, në Senatën amerikan, në Kongresin amerikan që unë do t'vi... kto janë disa nga momentet që mu m'u kanë dokë ndoshta sikur andërr.

Edhe jom mundu që mos m'i marrë si të dhuruara për mu, por si ni përgjegjësi t'madhe që duhet me ba shumë punë që ato m'i rujtë edhe me shfrytëzu mënyrën ma t'duhur edhe ma të mirë t'mundshme që t'i shërbej bashkëpunimit tonë me partnerë strategjik, po edhe t'ndërtojmë ura të reja lidhëse që do t'i shërbejnë shtetit ma gjatë. Për shembull, kjo qasja që m'u ka dhanë, për shembull në Pentagon ka qenë për mu si andërr, për shembull, me pasë qasje sikur në Ministri të Mbrojtjes sime.

Pastaj, relacionet që kem ndërtu me bashkëpunimin me partneritetin me garden ndërkombëtare të Iowa ku unë jom trajtu sikur t'isha gjeneral i ushtrisë amerikane me t'vërtetë, jo ni gjeneral i Kosovës. Ku unë kom pasë rastin, për shembull, përpos që t'jem ni partner të luj rolin edhe si një lider në hije i gardës kombëtare të Kosovës, ku unë jom pytë për rekomandime se si duhet t'shkoj, për shembull, për planin strategjik edhe zhvillimit t'gardës në elemente t'caktune.

Për shembull, jom shku dy javë, kam qenë si *Shadow Commander*, si komandant në hije i Gjeneralit Orr në ushtri me ushtaraken, në përgatitje, në planifikim, në ekzekutim, në analizë të ushtrimit me tri shtete ku kanë qenë gati 20 mijë trupa. Për shembull, unë t'pytem edhe me t'cilat pajisje ose me cilat automjete duhet t'bohet transporti, me cilin helikopter. Ato ishin diçka që nuk mundem m'i përshkru. Pastaj, misionin e fundit kur kom vendosë m'u pensionu nga ushtria... vendosjen për pensionim e kom ba kur osht' hapë mundësia e hapjes së Konzullatës në Iowa.

Edhe pas hapjes, aprovimit të dy shteteve amerikane dhe e Kosovës për hapjen e misionit, tre ose katër muj nuk osht' paraqitë askush i interesum që t'shkoj të vendoset në misionin në Iowa nga Ministria e Punëve të Jashtme. Atëherë unë e kom pasë ni thirrje nga Gjenerali Orr, isha në Washington edhe kisha ni thirrje se, interesante se qysh me thanë, m'ka prekë mu n'atë... çka kom dashtë unë me ba edhe në dy-tri vitet e ardhshme, ma ka ndrru pak atë planin tim që kom pasë n'vizion si qëllim çka me bo për dy-tri vitet e ardhshme.

Normalisht, që kam qenë njo prej iniciatorëve që bashkëpunimi me Iowa m'u zhvillu n'këtë nivelin që osht' tash edhe hapjen e konzullatës, kom bo përpjekjet e mia që m'kanë taku që konzullata m'u hapë. Normalisht aty kanë mbështetjet e dy qeverive e gjeneralve tjerë të Ushtrisë të Kosovës edhe të Iowas, të ministrave, të presidentëve, të kryeministrave e tjerë. Po unë e kom lujtë rolin tem aty. Mirëpo, kur u ardhë puna që kanë nejtë tre ose katër muj pa askënd në mision, atëherë Gjenerali u ardhë m'ka thirrë.

M'ka thanë, "Xhavit, *this is supposed to work two ways*", a p'e din, "Duhet me punu në dy antë, jo veç njanën anë. Na ju kemi mbështetë, kem gjetë lokacionin e mirë për konzullatë". Ata bile u angazhunë edhe pajisjet, orenditë për zyre, njerëzit lokal ushtarak edhe civil i vendosën aty pa neve. Unë shkoja ndonjëherë për shkak të vizitave t'mija zyrtare tri deri n'pesë, shtatë herë n'vit kam shku prej vitit 2011 po s'kom menu asniherë që unë do t'jem konsullatë në kapacitetin civil në Iowa. Mirëpo ai momenti ka qenë kur nuk shkoi askush edhe unë jom, i kom thanë Gjeneralit Orr, "Okej, kemi bo zgjidhje". Edhe meniherë m'ka shku menjë, "Okej nëse s'kanë kërkond në Kosovë, atëherë unë kom me marrë kta edhe kom me themelu konzullatën".

Unë pastaj i kom bo ato komunikimet e mia edhe me, atëherë ka qenë Ministër i Punëve të Jashtme dhe Zëvendës Kryeministër Hashim Thaçi, me komandantin e FSK-së, ministrin e FSK-së, me t'gjithë kom bisedu ma s'pari a osht' dikush... edhe Petrit Selimi m'duket ka qenë Zëvendës Ministër i Punëve të Jashtme. "A e keni dikond që osht' i caktum ose që u prit me shku atje?" "Jo, jo, jo s'po kem", "Pse?" "S'po mujmë me gjetë dikon. Kërkush s'po osht' i interesum". Atëherë ju kom thanë, "Çka nëse unë lajmërohem? A mundem unë me shku me hapë konzullatën, veç unë nuk rri ma shumë se dy vjet. Dy vite derisa te boj operacionale edhe e hapi konzullatën?"

Qëllimi jem ka qenë sepse unë menojsa pas punës sime si atache, n'atë kohën e nejtë isha duke diplomuar nga Kolegji i Luftës që bona Master Strategic Studies edhe qëllimin e kisha unë ma shumë që t'vi t'kontriboj pas marrjes së atij edukimi në ndërtimin e vizionit edhe ushtrisë të Kosovës edhe tri vite. Pra, s'mendoja që të pensionohem. E bona kërkesën që unë t'lejohej të punoj për dy vjet tranzicion, transfer m'fal, nga Ministria e Mbrojtjes në Ministrinë e Punëve të Jashtme, derisa t'bohët konzullata operacionale.

Në parim m'u aprovu ajo që unë në të vërtetë nga maji deri n'gusht t'i kryj dy puntë. Edhe e kam vendimin që më është lshu, që t'kryj edhe punën si atache ushtarak në Washington, po t'njejtën kohë të shërbej edhe si Konzull i Përgjithshëm në detyrë për Iowa. Pra, i kryja ato dy punë paralelisht nga Washingtoni dhe në Iowa. Ndërsa fatkeqësisht ose fatmirësisht m'u kthy një informatë nga Ministria e Mbrojtjes së Komandantëve, Sekretari i Përgjithshëm, tha, unë nëse du që t'shkoj në konzullatë në Iowa, atëherë duhet të jepi dorëheqje, të pensionohem vullnetarisht nga ushtria.

Tash, kishin fillu procedurat e akreditimit tim, ish njoftu qeveria amerikane edhe në Washington, po edhe autoritetet në Iowa që unë jom duke lujtë atë detyrë edhe kishim aktivitete, një sërë aktivitetesth

kishim marrë për atë punë. Po mu nuk m'u aprovu që t'vazhdojë në ushtri nëse e marrë atë. Edhe u dashtë që unë t'vendosi a du anej, a du knej. Pra unë mund të kthehesha në FSK e të vazhdojë karrierën edhe sa vite, po atje nuk ishte askush. Pra, detyra ishte hapur.

Atëherë normalisht prapë e kom bisedu edhe me Valentinën edhe ajo m'ka thanë, "Unë s'kom qef ti me lanë uniformën masi ke vendosë e masi e ke kry krejt këtë përvojë edhe këtë edukim. Ma mirë shkon kontribon atje". Masanej kur i kom shpjegu se çka muj me arritë me mision për Kosovën, bashkëpunimin, sidomos e kom pasë fokusin në edukim. E di që edukimi në Kosovë ende nuk është aty ku duhet edhe i patëm ndërtu relacione edhe nga aspekti ushtarak me t'gjitha kolegjet, universitetet në Iowa. Po ashtu e kanë pasë një prej pesë Odave Ekonomike ma t'mdhaja në Amerikë është në Iowa, Greater Des Moines Partnership. Me ata patëm ndërtu raporte edhe personale, shoqërore, jo vetëm institucionale. Edhe aty e shisha si ni potencial që ata mujnë me na ndihmu edhe në aspektin ekonomik si Kosovë.

Pastaj ishin sportet, lidhja e sporteve, binjakëzimi i qyteteve. Na vetëm lidhëm, fillim me bo binjakëzim të qyteteve edhe ngjallëm interesim që të binjakëzohen ma shumë qytete. Shishim potencial edhe në zhvillimin e start up-ave, inovacion, ktyne iniciativave inovative. Edhe ia shpjegova Valentinës edhe prapë menojsha që, "Okej, i kryj dy vjet edhe kthehna ktu në ushtri", a po kupton. Po, për shembull, me mundësitë që kemi pasë m'i kry për shtetin Iowa nuk e kthej kurrë ndryshe, nuk e kisha kthy kurrë ndryshe me bo diçka tjetër. Pra, jom shumë i lumtur që kemi kto raporte, kto komunikime edhe unë kom qenë vetëm një instrument, një vegël e krijimit të ktyne raporteve. Normalisht, shtetit tonë të Kosovës me shtetin amerikan po n'Veçanti edhe me shtetin e Iowa.

Anita Susuri: Edhe ju tashmë qe 17 vite jeni pensionu, sa i përket...

Xhavit Gashi: Në ushtri, po.

Anita Susuri: Pastaj keni vazhdu...

Xhavit Gashi: Edhe tri vite në Iowa si Konzull i Përgjithshëm pra.

Anita Susuri: Sot me çka mirreni? Na tregoni pak.

Xhavit Gashi: Po. Sot mirrem, fillimisht e kom regjistru ni *consulting company*, domethonë, kompani konsulente me t'cilen kom menu me punu bashkë me Gjeneralin Orr, i cili është në pension. Mirëpo, pas COVID-it por edhe para COVID-it, ata e thirrën edhe pse u pensionua e riaktivizunë në Sektorin Civil në Pentagon. Edhe pasaj mu m'u ofrun disa mundësi me punu me Cactus. M'u ofru një mundësi me Cactus për një zhvillim strategjik të bizneseve. Pra, ku jom tash. Edhe në Odën Ekonomike Amerikane, si këshilltar i jashtëm.

Pra s'fundi tash para ni muji kom fillu pas një oferte që më është bo edhe nga Universitetin Amerikan Kosovo RIT që unë të ligjërojë ni landë ushtarake që osht' *Four or two army leadership in a complex world*, pra lidhshipi ushtarak në botën komplekse që m'lidhet edhe me gjithë përvojën teme që kom pasë prej fillimit se në një formë ose tjetër bota n'cilën kom punu e kom vepru edhe zhvillu, jom zhvillu ka qenë komplekse. Edhe dukimi që kom pasë, për shembull, sidomos magistraturën në Kolegjin e Luftës, pra është kryesisht fokusohet në përgatitjen e lidhshiptit strategjik në ambientin kompleks të paparashikum të dy kuptimshëm.

Anita Susuri: Përveç domethonë angazhimit t'juj, e përmendet bashkëshorten e juj po po du edhe me ju pytë si jeni taku me bashkëshorten e juj? Si jeni njoftu?

Xhavit Gashi: Po, shumë interesant. Me Valentinën osht' interesant. Unë e din edhe Valentina, për shembull, para lufte kom kalu me femra. Nuk jom kanë avanturist, po për shembull ni kohë m'ka pëlqy ni femër jem pajtu, kem kalu. Ka ndodhë që ka vendosë që, prej ni lidhje, njani nga ne ka vendosë që t'mos jem ma bashkë ose kështu. Po si t'ritë atëherë edhe ashtu. Mirëpo, pas luftës e kom, njo prej qëllimeve tjera që s'kom pasë osht' që nuk kom dashtë të martohem menjëherë. Nuk kom dashtë t'martohem, s'e kom pasë synim.

Një e afërm e imja e familjes ma ka rekomandu Valentinën, që në një formë e njëfke Valentinën shumë mirë. Edhe përmes prindërve t'saj kishte edhe Valentinën t'afërt indirekt kështu. Unë ka ndodhë ndoshta për dy-tre muaj jom mundu m'i tregu asaj t'shoqës ose t'afërmes tonë që unë nuk jom i interesuar, as s'po du m'u taku, a po kupton, as s'po du m'u taku, se s'kom interesim. Ma s'pari as s'kisha, pra isha n'atë fazën kur kisha vendosë me nejt ni vjet me TMK-në ose atë farë transformimi. Tjetra ishte edhe shpia, s'kishim as shpi, për shembull. Tjetra ish, qëllimi im ish që t'mos fokusohem në martesë ose n'lidhje pa e kry fakultetin. E nuk dija çka do t'ndodhë me mu pas ni viti. Çka do t'bojë.

Mirëpo, pas tre mujve ashtu na rastiti u takum me Valentinën edhe m'pëlqej edhe n'shiqim të parë. Po pastaj edhe me bisedime e takime që jem taku me Valentinën edhe unë isha ai iniciatori pastaj, kur e kom pa Valentinën që t'nxitohem t'krijojmë lidhjen edhe t'krijomë familje ma shpejt. Qashtu, po. Edhe me t'vërtetë jam i beku me familjen time, me Valentinën kryesisht, sepse ajo ka qenë shtyllë. Na e thojmë gjithëherë në ushtri, "Nuk ka lidhje çfarë grade ti ki, po gruja ka ni gradë ma shumë". Po na e kem pa me të vërtetë e kem dëgju, po nuk osht' vetëm retorikë n'rastin tem të paktën, me thanë që, për shembull, nëse unë kom qenë i suksesshëm ose nëse unë kom mujtë me bo punë t'mira për shtet osht' normalisht për angazhimin tem që m'u ka dhanë, por pa mbështetjen e Valentinës nuk kisha mujtë asniherë m'i bo krejt kto që i kom bo.

Sot jetojmë bashkë t'lumtur, unë jom n'pension po boj hajgare kaniherë, "Nuk jom plakë", po Valentina vazhdon me më mbështetë në çkado që unë t'boj, tash edhe n'sektorin privat. Normalisht, ajo dëshira saj ka qenë që unë të vazhdojë edhe disa vite n'ushtri atëherë, por rrethanat u krijun ashtu. Po osht' e lumtur edhe me vendimet tjera që i kom marrë n'jetë. I kom tre fëmi, Vala osht' vajza ime gëzimi i parë,

ajo tani studion në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Psikologji është në Iowa. Pra, në shtetin që kem për zemër tanë na familja. Drini osht' në vitin e fundit të shkollës të mesme, pra n'klasën e dymbëdhjetë. Ai si i ri i ndryshon mendimet për drejtimin e tij profesional. Don ndoshta nga ushtria, po nuk i dihet. Ndërsa e kemi edhe njo t'vogël, gjashtë vjet Lisin, edhe që na mban ma aktiv ma qashtu.

Anita Susuri: Mirë shumë. Deshta edhe për fund me iu pytë, jemi në vitin 2021 edhe jemi gjatë pandemisë. Si po e ballafaqoni ju këtë kohë edhe si ka qenë për juve fillimisht karantina, pastaj gjithë pandemia që po vazhdon? A keni vështirësi? A keni pasë dikond që osht' smu apo?

Xhavit Gashi: Fatmirësisht në familje të ngushtë nuk kemi pasë, po fatkeqësi si të gjithë andej jemi t'rrethum prej njerëzve që kanë vujtë nga COVID-i. Njoh njerëz që n'forma t'ndryshme, ndoshta jo shokë t'afërm, por njoh njerëz që kom njoftë edhe n'moshën ndoshta ma t'ri se unë se kanë vdekë, kanë psu fatkeqësisht. Po m'dhemë çdo rast kur dëgjoj për njerëzit që vujnë ma shumë, që i godet ma shumë COVID-i.

Unë n'këtë kohë, për shembull, n'kohën e karantinës ne kemi fat që kemi edhe një banesë atje në Istog, ku kem kalu kohën ma t'madhe ku s'kem mujtë me lëvizë, bile t'paktën ajri është ma i pastër. Po menjëherë si kanë nisë t'lirohen pak sado-kudo edhe pse të kufizume masat, unë me kërkesë të Ministrisë së Shëndetësisë kom qenë pjesë e vogël të kontributit të një Këshilli, këshilldhënës, Bordi Këshilldhënës, ku kryesisht kanë qenë doktorë, profesorë, po vetëm dy kem qenë që nuk kem qenë nga sektori i mjeksisë.

Unë pra, që kemi bo hulumtime, analiza për menaxhimin më shumë nga aspekti i sigurisë, i emergjencave dhe një profesor, i cili ka qenë edhe Zëvendës Ministër i Arsimit që osht' marrë ma shumë me çështjet e edukimit. Po edhe pse nuk jemi goditë drejtpërdrejtë, normalisht na godet kjo që po ndodhë në shoqëri dhe me pa po shpresojmë që sa ma shpejt të kalojë edhe sa ma pak njerëz të infektohen ose ata që infektohen ma lehtë t'kalojnë.

Anita Susuri: Nëse keni edhe diçka për fund me shtu ose që keni harru me cekë, mundeni.

Xhavit Gashi: Faleminderit shumë për mundësinë, ka shumë për me thanë, po unë besoj për këtë është e mjaftueshme. Faleminderit shumë.

Anita Susuri: Në rregull. Faleminderit prej teje.